



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 100

2003

Dhjetor

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.9151 datë 6.11.2003	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së kredisë të zhvillimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim(IDA), për projektin e punëve të komunitetit-II”..... 4293
Ligj nr.9152 datë 6.11.2003	Për ratifikimin e “Memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Komunitetit Europian, për statusin e Misionit të Asistencës Policore të Komunitetit Europian në Shqipëri (PAMECA)”..... 4301
Ligj nr.9153 datë 6.11.2003	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8167, datë 21.11.1996 “Për shërbimin shëndetësor stomatologjik”, ndryshuar me ligjin nr.8414, datë 1.10.1998..... 4310
Ligj nr.9154 datë 6.11.2003	Për arkivat..... 4311
Vendim i KM nr.795, datë 26.11.2003	Për ngritjen, përbërjen dhe mënyrën e funksionimit të komisionit të përhershëm të vlerësimit të objekteve të trashëgimisë kulturore, në pronësi private, të luajtshme dhe për kriteret shkencore e procedurat e vlerësimit të këtyre objekteve..... 4329
Vendim i KM nr.796, datë 26.11.2003	Për miratimin e ndryshimit të Marrëveshjes së kredisë për zhvillim "Projekti i reformës ligjore dhe gjyqësore", ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA)..... 4333

L I G J
Nr.9151, datë 6.11.2003

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË KREDISË TË ZHVILLIMIT, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM
(IDA), PËR PROJEKTIN E PUNËVE TË KOMUNITETIT-II”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e kredisë së zhvillimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin e punëve të komunitetit – II”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.4015, datë 2.12.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJA
E KREDISË PËR ZHVILLIM NDËRMJET SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE
PËR ZHVILLIM
(PROJEKTI I II I PUNËVE TË KOMUNITETIT)

Marrëveshje, datë 24 korrik 2003, ndërmjet Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (Shoqata).

Meqë: (A) Huamarrësi, duke qenë i bindur për mundësinë e realizimit dhe përparësinë e projektit të përshkruar në shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje (Projekti), ka kërkuar nga Shoqata që ta ndihmojë në financimin e projektit.

(B): Projekti do të realizohet nga Fondi i Zhvillimit Shqiptar (FZSH) me ndihmën e Huamarrësit dhe, si pjesë e kësaj ndihme, Huamarrësi do të vërë në dispozicion të FZSH-së shumat e kredisë parashikuar në nenin II të kësaj Marrëveshjeje (Kredi), siç janë përcaktuar në këtë Marrëveshje, dhe

meqë Shoqata ka pranuar, në bazë, ndër të tjera, të pohimeve të mësipërme, që të japë kredi tek Huamarrësi sipas kushteve dhe konditave të përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe në marrëveshjen në po këtë datë ndërmjet Shoqatës dhe FZSH-së (Marrëveshja e projektit),
prandaj palët bien dakord për sa vijon:

Neni 1

Kushtet e përgjithshme; përkufizimet

Seksioni 1.01 "Kushtet e përgjithshme për t'u zbatuar në marrëveshjet e kredisë për zhvillim" të Shoqatës, nënshkruar më datën 1 janar 1985, (ndryshuar në 6 tetor 1999), (Kushtet e përgjithshme), përbëjnë pjesën integrale të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 1.02 Përveç rasteve kur konteksti kërkon ndryshe, termat e përcaktuar në kushtet e përgjithshme kanë kuptimet përkatëse të përcaktuara këtu më poshtë dhe termat plotësues që pasojnë

kanë kuptimet e mëposhtme:

a) "FZSHH" i referohet Fondit të Zhvillimit Shqiptar, krijuar si një organ ligjor, i pavarur, me vendim të qeverisë, nr.427, më 8 shtator 1994, amenduar me vendim qeverie nr.207, më 28 prill 1999.

b) "Përfituesi" ose "Përfituesit" i referohet njërive qeveritare ose joqeveritare, si fshatrat, komunat, bashkitë ose shoqatat, të cilat premtojnë të kryejnë nënprojektet sipas pjesës A të projektit.

c) "Raporti i monitorimit financiar" ose RMF i referohet çdo raporti të përgatitur në përputhje me seksionin 4.02 të kësaj Marrëveshjeje.

d) "Marrëveshja e projektit" i referohet marrëveshjes ndërmjet Shoqatës dhe FZSHH-së, të po kësaj date, pasi e njëjta mund të amendohet herë pas here, dhe ky kusht përfshin të gjitha shtojcat dhe marrëveshjet shtesë të projekt marrëveshjes.

e) "Paradhënia për përgatitjen e projektit" i referohet paradhënies për përgatitjen e projektit dhënë nga Shoqata tek Huamarrësi sipas një letërmarrëveshjeje, nënshkruar në emër të Shoqatës, më 13 shkurt 2003 dhe në emër të Huamarrësit, më 6 maj 2003.

f) "Rregullorja dhe manuali operacional" i referohet udhëzuesve që përmbajnë kriteret administrative, financiare, mjedisore, nxitëse, vlerësuese dhe mbikëqyrëse, si dhe politikën që do të ndjekë FZSHH-ja lidhur me pronat, e cila do të miratohet sipas dispozitave të paragrafit 3(b) të shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje.

g) "Llogari e veçantë" nënkupton llogarinë, referuar në seksionin 2.02 (b) të kësaj Marrëveshjeje.

h) "Nënprojekt" i referohet një nënprojekti të veçantë zhvillimi që do të realizohet nga përfituesi, duke shfrytëzuar shumat e një granti sipas pjesës A të këtij projekti.

i) "Nën marrëveshje" i referohet marrëveshjes që do të lidhet ndërmjet Huamarrësit dhe FZSHH-së sipas seksionit 3.01(b) të kësaj Marrëveshjeje; si e tillë mund të amendohet herë pas here, dhe ky kusht përfshin çdo shtojcë tek nën marrëveshja.

Neni 2

Kredia

Seksioni 2.01 Shoqata pranon t'i japë Huamarrësit, sipas kushteve dhe konditave të përcaktuara ose të përmendura në Marrëveshjen e kredisë për zhvillim, një shumë në valuta të ndryshme baras me dhjetë milionë e nëntëqind mijë të drejta të posaçme tërheqëse (SDR 10 900 000).

Seksioni 2.02 (a) Shuma e kredisë mund të tërhiqet nga llogaria e kredisë në përputhje me dispozitat e shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje për:

i) shpenzimet e bëra (ose, nëse Shoqata pranon të bëhen) lidhur me koston e arsyeshme të mallrave, punimeve dhe shërbimeve të nevojshme për projektin (përveç pjesës A të projektit) dhe që do të financohen nga shumat e kredisë dhe

ii) shumat e paguara (ose, nëse Shoqata do të jetë dakord të paguhen) nga FZSHH-ja në llogari të tërheqjeve të bëra respektivisht nga përfituesit sipas një nënhuaje për të plotësuar koston e arsyeshme të mallrave, punimeve dhe shërbimeve të kërkuara për pjesën A të projektit, në lidhje me të cilin është kërkuar tërheqja nga llogaria e kredisë.

b) Huamarrësi, për nevojat e projektit, mund të hapë dhe të mbajë një llogari depozite speciale në dollarë në një bankë me kushte dhe kondita të pranueshme për Shoqatën, duke përfshirë mbrojtjen e duhur nga konfiskimi dhe ndalimi. Depozitat në dhe pagesat nga llogaria speciale do të bëhen në përputhje me dispozitat e shtojcës 3 të kësaj Marrëveshjeje.

c) Menjëherë pas datës efektive, Shoqata, në emër të Huamarrësit, do të tërheqë nga llogaria e kredisë dhe do t'i paguajë vetes shumën e kërkuar për të shlyer kapitalin fillestar të paradhënies për përgatitjen e projektit të tërhequr dhe papaguar deri në këtë datë, dhe të paguajë të gjitha detyrimet e papaguara. Pas kësaj, pjesa e patërhequr e shumës së autorizuar për paradhënien e përgatitjes së projektit do të anulohet.

Seksioni 2.03 Data e mbylljes është 30 shtator 2008 ose një datë e mëvonshme që e përcakton Shoqata. Shoqata, menjëherë, do të njoftojë Huamarrësin lidhur me datën e mëvonshme.

Seksioni 2.04 (a) Huamarrësi do t'i paguajë Shoqatës një pagesë angazhimi mbi shumën principale të kredisë së patërhequr nga koha në kohë me një vlerë të caktuar nga Shoqata, duke filluar më 30 qershor të çdo viti, por duke mos tejkaluar vlerën e një gjysmë përqindëshi (1/2 e 1%) në vit.

b) Pagesa e angazhimit do të rritet: (i) gjashtëdhjetë ditë nga data e nënshkrimit të kësaj

Marrëveshjeje (data rrjedhëse) deri në datat respektive në të cilat shumat do të tërhiqen nga Huamarrësi nga llogaria e kredisë ose do të anulohen; (ii) në interesin e caktuar më 30 qershor menjëherë para datës rrjedhëse ose me një interes tjetër që pastaj mund të përcaktohet nga koha në kohë në përputhje me paragrafin (a) më sipër. Interesi i caktuar më 30 qershor në çdo vit do të aplikohet nga data pasuese në atë vit që specifikohet në pjesën 2.06 të kësaj Marrëveshjeje.

c) Pagesa e angazhimit do të paguhet: (i) në ato vende që Shoqata në mënyrë të arsyeshme do të kërkojë; (ii) pa kufizime të çfarëdolloji që mund të imponohen nga, ose në territorin e Huamarrësit; (iii) në monedhë të përcaktuar në këtë Marrëveshje për nevojat e pjesës 4.02 të kushteve të përgjithshme ose në monedha të tjera të pranueshme që nga koha në kohë mund të përcaktohen ose të zgjidhen në përputhje me dispozitat e këtij seksioni.

Seksioni 2.05 Huamarrësi do t'i paguajë Shoqatës një pagesë shërbimi me një interes prej tre të katërtat e një përqindëshit (3/4 e 1%) në vit të shumës principale të kredisë së tërhequr dhe të papaguar nga koha në kohë.

Seksioni 2.06 Pagesat e angazhimit dhe pagesat e shërbimeve do të paguhën dy herë në vit më 15 maj dhe 15 nëntor të çdo viti.

Seksioni 2.07 Huamarrësi do të ripaguajë shumën principale të kredisë në këstet 6-mujore çdo 15 maj dhe 15 nëntor, duke filluar nga 15 nëntori 2013 dhe duke përfunduar më 15 maj 2023. Çdo këst duhet të jetë 5 për qind (5%) e shumës principale.

Seksioni 2.08 Monedha e Shteteve të Bashkuara të Amerikës caktohet si monedha e përdorshme për qëllimet e seksionit 4.02 të kushteve të përgjithshme.

Seksioni 2.09 FZSHH-ja është caktuar si përfaqësuese e Huamarrësit për të ndërmarrë çdo veprim të kërkuar ose të lejuar për t'u marrë sipas dispozitave të seksionit 2.02 të kësaj Marrëveshjeje dhe nenit 5 të kushteve të përgjithshme.

Neni 3

Zbatimi i projektit

Seksioni 3.01 (a) Huamarrësi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivave të projektit, të përcaktuara në shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe, për këtë qëllim, pa ndonjë kufizim ose pengim të detyrimeve të tij të tjera sipas Marrëveshjes së kredisë për zhvillim, do të sigurojë që FZSHH-ja të kryejë, në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së projektit, të gjitha detyrimet e përcaktuara, do të ndërmarrë ose do të sigurojë që të ndërmerrin të gjitha veprimet, përfshirë sigurimin e fondeve, pajisjeve, shërbimeve dhe burimeve të tjera të nevojshme ose të përshtatshme për të bërë të mundur që FZSHH-ja të realizojë këto detyrime, dhe nuk do të ndërmarrë ose nuk do të lejojë të ndërmerrin ndonjë veprim që do të parandalonte ose do të ndërhynte në kryerjen e detyrimeve të tilla.

b) Huamarrësi do të bëjë disponibël tek FZSHH-ja shumat e kredisë sipas nënmarrëveshjes që do të lidhet ndërmjet Huamarrësit dhe FZSHH-së sipas kushteve dhe konditave, të cilat janë miratuar nga Shoqata.

c) Huamarrësi do të ushtrojë të drejtat e tij sipas nënmarrëveshjes në mënyrë të tillë që të mbrojë interesat e Huamarrësit dhe Shoqatës dhe që të përmbushë synimet e kredisë dhe, përveç kur shoqata bie dakord ndryshe, Huamarrësi nuk do të caktojë, ndryshojë, abrogojë ose të heqë dorë nga nënmarrëveshja ose nga ndonjë dispozitë e saj.

Seksioni 3.02 Përveç kur Shoqata bie dakord ndryshe, prokurimi i mallrave, punimeve dhe shërbimet e konsulentëve të nevojshëm për projektin dhe që do të financohen nga shumat e kredisë do të kryhen në përputhje me dispozitat e shtojcës 1 të Marrëveshjes së projektit.

Seksioni 3.03 Për qëllimet e seksionit 9.06 të kushteve të përgjithshme dhe pa kufizim, Huamarrësi:

a) do të përgatisë në bazë të udhëzuesve të pranueshëm nga Shoqata dhe të pajisë Shoqatën jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas datës së mbylljes, ose më vonë se kjo datë, siç mund të jetë rënë dakord për këtë qëllim ndërmjet Huamarrësit dhe Shoqatës, me një plan për aktivitetin e projektit në të ardhmen dhe

b) do t'i japë Shoqatës një mundësi për të shkëmbyer mendime me Huamarrësin për planin në

fjalë.

Seksioni 3.04 Përveçse kur Shoqata bie dakord ndryshe, Huamarrësi nuk do të ndryshojë, shndërrojë dhe nuk do të bëjë të mundur ose nuk do të lejojë FZSHH-në të korrigjojë, të ndryshojë rregulloren dhe manualin operacional.

Seksioni 3.05 Huamarrësi dhe Shoqata në këtë mënyrë bien dakord që detyrimet e përcaktuara në seksionin 9.03, 9.04, 9.05, 9.06, 9.07 dhe 9.08 të kushteve të përgjithshme (lidhur me sigurimet, përdorimin e mallrave dhe shërbimet, planet dhe programet, dokumentet dhe relacionet, mirëmbajtjen dhe pronat respektivisht) do të kryhen nga FZSHH-ja, në përputhje me seksionin 2.03 të Marrëveshjes së projektit.

Neni 4

Konventat financiare

Seksioni 4.01 (a) Për të gjitha shpenzimet në lidhje me të cilat janë bërë tërheqjet nga llogaria e kredisë bazuar në dokumentet e shpenzimeve, Huamarrësi:

i) do të ruajë ose do të sigurojë mbajtjen, në përputhje me praktikat e kontabilitetit, të dokumenteve dhe llogarive të veçanta që pasqyrojnë këto shpenzime;

ii) do të sigurojë që të gjitha dokumentet, (kontratat, kërkesat, faturat, vërtetimet dhe dokumente të tjera) që vërtetojnë këto shpenzime, të ruhen të paktën për një periudhë njëvjeçare, pasi Shoqata të ketë marrë raportin e revizionit për vitin fiskal në të cilin është bërë tërheqja e fundit nga llogaria e kredisë;

iii) do të lejojë përfaqësuesit e Shoqatës që t'i kontrollojnë këto dokumente.

b) Huamarrësi:

i) do të mbajë dokumentet dhe llogaritë, referuar në paragrafin (a) (i) të këtij seksioni, përfshirë ato për llogarinë speciale për çdo vit fiskal të audituar, në përputhje me parimet e duhura audituese të aplikuara me përpikmëri nga auditor të pavarur të pranueshëm për Shoqatën;

ii) do të pajisë Shoqatën menjëherë sapo të jetë e gatshme, por në çdo rast jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të çdo viti në të cilin është kryer, me raportin e auditimit nga auditorët në fjalë me përmasa dhe hollësi të tilla që Shoqata i kërkon në mënyrë të arsyeshme, përfshirë një opinion të veçantë nga auditorët në fjalë, nëse deklaratat për shpenzimet e paraqitura gjatë këtij viti fiskal së bashku me procedurat dhe kontrollin e brendshme të përdorura në përgatitjen e tyre, mund të jenë bazë për të vërtetuar tërheqjet përkatëse;

iii) do të pajisë herë pas here Shoqatën me informacione të tjera lidhur me dokumentet, llogaritë dhe auditimet e përmendura sipas kërkesës së Shoqatës.

Neni 5

Masat ndëshkuese të Shoqatës

Seksioni 5.01 Në përputhje me seksionin 6.02 (1) të kushteve të përgjithshme përcaktohen rastet e mëposhtme kur:

a) FZSHH-ja nuk do arrinte të realizonte ndonjë nga detyrimet sipas Marrëveshjes së projektit;

b) si rezultat i ngjarjeve, të cilat kanë ndodhur mbas datës së Marrëveshjes së kredisë për zhvillim, janë krijuar situata të pazakonta, të cilat bëjnë të pamundur që FZSHH-ja të ketë mundësi të realizojë detyrimet e saj sipas Marrëveshjes së projektit;

c) rregullorja dhe manuali operacional do të ndryshojë, do të pezullohet, do të abrogohet, do të shfuqizohet ose do të nxirret jashtë përdorimit, pasi ndikojnë materialisht dhe negativisht, sipas mendimit të Shoqatës, në realizimin e projektit.

Seksioni 5.02 Në përputhje me seksionin 7.01 (h) të kushteve të përgjithshme përcaktohet edhe rasti i mëposhtëm që do të thotë se çdo rast i përcaktuar në paragrafin (a) dhe (c) të seksionit 5.01 të kësaj Marrëveshjeje do të ndodhë dhe do të vazhdojë për një periudhë prej 60 ditësh pas njoftimit bërë Huamarrësit nga Shoqata.

Neni 6

Data e hyrjes në fuqi, përfundimi

Seksioni 6.01 Rastet e mëposhtme janë përcaktuar si kushte shtesë për efektshmërinë e Marrëveshjes së kredisë për zhvillim në kuadër të përcaktimit të seksionit 12.01 (b) të kushteve të përgjithshme.

a) Nënmarëveshja është zbatuar në emër të Huamarrësit dhe FZSHH-së.

b) Vendimi i qeverisë n.207, datë 28 prill 1999 është ndryshuar nga Këshilli i Ministrave në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Shoqatën.

Seksioni 6.02 Çështjet e mëposhtme janë përcaktuar si shtesë brenda kuptimit të seksionit 12.02 (b) të kushteve të përgjithshme, për t'u përfshirë në opinionin ose opinionet me të cilat do të pajiset Shoqata:

a) që Marrëveshja e projektit është autorizuar ose ratifikuar në kohë nga FZSHH-ja dhe i është detyruar ligjërisht FZSHH-së në përputhje me kushtet e saj dhe

b) që nënmarëveshja është autorizuar ose ratifikuar siç duhet nga Huamarrësi dhe FZSHH-ja dhe i është detyruar ligjërisht Huamarrësit dhe FZSHH-së në përputhje me kushtet e saj.

Seksioni 6.03 Data, nëntëdhjetë (90) ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje, përcaktohet për qëllimet e seksionit 12.04 të kushteve të përgjithshme.

Neni 7

Përfaqësuesi i Huamarrësit; adresat

Seksioni 7.01 Me përjashtim siç tregohet në seksionin 2.09 të kësaj Marrëveshjeje, Ministri i Financave të Huamarrësit caktohet si përfaqësues i Huamarrësit për qëllimet e seksionit 11.03 të kushteve të përgjithshme.

Seksioni 7.02 Adresat e mëposhtme janë përcaktuar për qëllimet e seksionit 11.01 të kushteve të përgjithshme.

Për Huamarrësin:
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë
Albania
Faks: 35542 28495

Për Shoqatën:
International Development Association
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of America

Adresa Telegrafike
INDEVAS
Washington, D.C.

Teleks
248423 (MCI) ose (202)477-6391
64145 (MCI)

Para dëshmitarëve, palët nënshkruese, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë rënë dakord që kjo Marrëveshje të nënshkruhet me emrat e tyre përkatës në Tiranë, Shqipëri, në datën dhe vitin e lartshënuar për herë të parë.

Shqipëria
nga
Kastriot Islami
Ministër i Financave
Përfaqësuesi i autorizuar

Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim
nga Eugen Scanteie
Përfaqësuesi i autorizuar

1. Tabela e mëposhtme përcakton kategoritë e zërave që do të financohen nga shumat e kredisë, shpërndarjen e shumave të kredisë për çdo kategori dhe përqindjen e shpenzimeve për zërat që do të financohen në çdo kategori:

Kategoria	Shuma e kredisë së alokuar (shprehur në SDR të barasvlefshme)	% e shpenzimeve për t'u financiar
1. Granti sipas pjesës A të projektit	8 780 000	90%
2. Shërbimet e konsulentëve sipas pjesëve B dhe C të projektit	440 000	85%
3. Trajnime	150 000	100%
4. Pajisje sipas pjesës B dhe C të projektit	80 000	100% të shpenzimeve të huaja, 100% të shpenzimeve lokale (kostoja jashtë fabrikës) dhe 85% të shpenzimeve lokale për artikuj të tjerë të prokuruar në vend.
4.Kosto operacionale e shtuar	730 000	80% deri më 31 dhjetor 2004, 60% deri 31 dhjetor 2005, 40% deri 31 dhjetor 2006 dhe 20% deri në fund.
5. Rifinancimi i përgatitjes së projektit	370 000	Shuma e caktuar sipas seksionit 2.02 (c) të kësaj Marrëveshjeje.
7. Të paalokuara	350 000	
TOTALI	10 900 000	

2. Për nevojat e kësaj shtojce:

a) Termi "shpenzime të huaja" u referohet shpenzimeve në monedhën e çdo vendi tjetër përveç asaj të Huamarrësit për mallrat dhe shërbimet e siguruar nga territori i çdo vendi tjetër përveç atij të Huamarrësit.

b) Termi "shpenzime lokale" u referohet shpenzimeve në monedhën e Huamarrësit ose për mallrat ose shërbimet e siguruar nga territori i Huamarrësit.

c) Termi "kosto operacionale e shtuar" nënkupton kostot operacionale dhe të mirëmbajtjes, të cilat nuk do të ndodhnin në mungesë të projektit dhe përfshin, ndër të tjera, kostot për: (i) mirëmbajtjen dhe funksionimin e pajisjeve të prokuruar ose të përdorura për projektin; (ii) pagat e paguara për personelin e FZSHS-së, përveç atyre të punonjësve publikë të punësuar për nevojat e projektit dhe (iii) pajisje konsumi për zyrat, mjetet e komunikimit, karburanti, udhëtimet dhe dietat e stafit të FZSHS-së.

d) Termi "grante" nënkupton financimin për nënprojektet sipas pjesës A të projektit, në përputhje me rregulloren dhe manualin operacional.

e) Termi "trajnime" nënkupton shpenzimet e bëra nga Huamarrësi në lidhje me kryerjen e aktiviteteve të trajnimit në kuadër të projektit, përfshirë kostot e udhëtimit dhe dietat për instruktorët dhe të trajnuarit lokalë, për udhëtimet e studimit dhe seminarët, qiratë e mjeteve dhe pajisjeve, për materialet e trajnimit dhe pajisjet lidhur me të.

3. Pa marrë parasysh dispozitat e paragrafit 1 më sipër, asnjë tërheqje nuk mund të bëhet për: (a) pagesat bërë për shpenzime para datës së kësaj Marrëveshjeje dhe (b) shpenzimet sipas kategorisë (1) për pjesën A të projektit pa rishikimin dhe miratimin e rregullores dhe manualin operacional nga FZSHS-ja në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Shoqatën.

4. Shoqata mund të kërkojë të bëhen tërheqje nga llogaria e kredisë në bazë të deklaratave të shpenzimeve për shpenzimet sipas kontratave për: (i) punime që nuk e kalojnë shumën 150 000 \$ ekuivalent; (ii) mallra; (iii) firma konsulente që nuk kalojnë vlerën 100 000 \$ ekuivalent dhe për konsulentë individualë që nuk e kalojnë vlerën 25 000 \$ ekuivalent dhe (iv) për trajnime dhe kosto operacionale shtesë, sipas kushteve dhe konditave që do të përcaktojnë Shoqata duke njoftuar Huamarrësin.

SHTOJCA 2 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Qëllimet e projektit janë: (a) të ndihmojë Huamarrësin të nxisë zhvillimin e komunitetit bazuar në prioritetet e zhvillimit të pushteteve dhe komuniteteve lokale dhe (b) të ndërtojë kapacitetet e pushteteve vendore dhe komuniteteve lokale për të nxitur zhvillimin e ekonomisë lokale.

Projekti konsiston në pjesët e mëposhtme që janë objekt i ndryshimeve që herë pas here Huamarrësi dhe Shoqata mund të bien dakord për realizimin e këtyre objektivave.

Pjesa A: Programi i nënprojekteve të komunitetit

Sigurimi i grantit për nënprojektet tek përfutuesit për, ndër të tjera: (a) rehabilitimin e rrugëve; (b) riparimin ose shtrirjen e sistemit të kanalizimeve dhe të ujësjellësve; (c) riparimin dhe rindërtimin e shkollave dhe qendrave shëndetësore dhe ndërtesave të tjera publike; (d) ndërtimin ose rehabilitimin e tregjeve dhe (e) zhvillimin e programeve të dhënies së shërbimeve sociale.

Pjesa B: Ndërtimi i kapaciteteve të pushtetit lokal dhe komunitetit lokal

Sigurimi i trajnimeve dhe shërbimeve të konsulencës teknike për stafin e pushtetit lokal, stafin e FZSHS-së, ndër të tjera, vlerësimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e nënprojektit; kujdesi për ambientin dhe prokurimi. Zhvillimi i një programi të vlerësimit dhe monitorimit pjesëmarrës.

Pjesa C: Mbështetja e zbatimit të projektit

Përmirësimi i kapacitetit institucional të FZSHS-së, ndër të tjera, vlerësimin e impaktit të aktiviteteve të saj dhe identifikimin, përgatitjen, vlerësimin, supervisionin dhe nxitjen e nënprojekteve dhe në kryerjen e aktiviteteve për forcimin e kapaciteteve në pushtetet vendore dhe komunitetet lokale nëpërmjet dhënies tek FZSHS-ja të asistencës teknike trajnimit dhe pajisjeve.

Projekti parashikohet të përfundojë deri në 31 mars 2008.

SHTOJCA 3 LLOGARIA SPECIALE

1. Për qëllimet e kësaj shtojce:

a) Termi "kategori të pranueshme" nënkupton kategoritë (1) deri (6) të paraqitura në tabelën në paragrafin 1 të shtojcës të kësaj Marrëveshjeje.

b) Termi "shpenzime të pranueshme" nënkupton shpenzime lidhur me koston e arsyeshme të mallrave dhe të shërbimeve të kërkuara për projektin dhe që do të financohen nga shumatat e kredisë, të shpërndara herë pas here në kategori të pranueshme, sipas kushteve të shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje.

c) Termi "shpërndarje e autorizuar" nënkupton një shumë ekuivalente me 1 500 000 \$ që do të tërhiqet nga llogaria e kredisë dhe depozitohet në llogarinë speciale, sipas paragrafit 3 (a) të kësaj shtojce, me kusht që, përveçse kur Shoqata bie dakord ndryshe, shpërndarja e autorizuar do të limitohet në shumën ekuivalente deri në 750 000 \$ deri sa shuma totale e tërheqjeve nga llogaria e kredisë do të jetë e barabartë ose kalon ekuivalentin prej SDR 2 000 000.

2. Pagesat nga llogaria speciale do të bëhen ekskluzivisht për shpenzime të pranueshme në përputhje me kushtet e kësaj shtese.

3. Pasi Shoqata ka marrë një evidencë të pranueshme për të se llogaria speciale është hapur në kohën e duhur, do të bëhen tërheqjet e shpërndarjes së autorizuar dhe tërheqjet pasuese për të rimbushur llogarinë speciale, si më poshtë:

a) Për tërheqjet e shpërndarjes së autorizuar, Huamarrësi do t'i paraqesë Shoqatës një kërkesë apo kërkesa për depozitë në llogarinë speciale të një shume ose të shumave, të cilat nuk e kalojnë shumën totale të shpërndarjes së autorizuar. Mbi bazën e një kërkesë apo kërkesave të tilla, Shoqata, në emër të Huamarrësit, do të tërheqë nga llogaria e kredisë dhe do të depozitojë në llogarinë speciale këtë shumë apo shumatat e kërkuara nga Huamarrësi.

b) (i) për rimbushjen e llogarisë speciale, Huamarrësi do t'i paraqesë Shoqatës kërkesa për depozitë në llogarinë speciale në intervalet që do të specifikojë Shoqata.

ii) Përpara ose në kohën e çdo kërkesë të tillë, Huamarrësi do t'i paraqesë Shoqatës dokumentet dhe evidenca të tjera të kërkuara sipas paragrafit 4 të kësaj shtojce për pagesën apo pagesat, në lidhje me çdo rimbushje të kërkuar. Mbi bazën e çdo kërkesë të tillë, Shoqata, në emër të Huamarrësit, do të tërheqë nga llogaria e kredisë dhe do të depozitojë në llogarinë speciale shumën e

kërkuar nga Huamarrësi dhe të provuara në dokumentet dhe evidencat e tjera që janë paguar nga llogaria speciale për shpenzime të pranueshme. Të gjitha këto depozita do të tërhiqen prej Shoqatës nga llogaria e kredisë sipas kategorive respektive të pranueshme dhe në lidhje me shumat ekuivalente të justifikuara nga dokumentet apo evidencat e tjera.

4. Për çdo pagesë të bërë nga Huamarrësi nga llogaria speciale, Huamarrësi, në kohën që Shoqata në mënyrë të arsyeshme do ta kërkojë, do ta pajisë Shoqatën me dokumente dhe evidenca të tjera të tilla që tregojnë se pagesa të tilla janë bërë ekskluzivisht për shpenzime të arsyeshme.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 3 të kësaj shtojce, Shoqatës nuk do t'i kërkohej të bëjë depozita të mëtejshme në llogarinë speciale:

a) nëse, në ndonjë rast, Shoqata ka vendosur që të gjitha tërheqjet e mëtejshme të bëhen prej Huamarrësit direkt nga llogaria e kredisë në përputhje me dispozitat e nenit 5 të kushteve të përgjithshme dhe paragrafit (a) të seksionit 2.02 të kësaj Marrëveshjeje;

b) nëse Huamarrësi nuk ka arritur t'i paraqesë Shoqatës, brenda afatit të specifikuar në seksionin 4.01 (b) (ii) të kësaj Marrëveshjeje, ndonjë nga raportet e auditimit të kërkuar për t'iu paraqitur Shoqatës sipas seksionit në fjalë lidhur me kontrollin e dokumenteve dhe llogarive për llogarinë speciale;

c) nëse, në ndonjë rast, Shoqata ka njoftuar Huamarrësin se ka ndërmend të ndalojë plotësisht apo pjesërisht të drejtën e Huamarrësit për të bërë tërheqje nga llogaria e kredisë sipas kushteve të seksionit 6.02 të Kushteve të Përgjithshme ose

d) sapo shuma totale e tërhequr e kredisë së shpërndarë në kategoritë e përshtatshme, minus shumën totale të të gjithë angazhimit special të papaguar derdhur nga Shoqata, sipas seksionit 5.02 të kushteve të përgjithshme përsa i përket Projektit, do të barazojë ekuivalentin e dyfishit të shumës së shpërndarjes së autorizuar.

Si pasojë, tërheqja nga llogaria e kredisë e shumës së mbetur pa tërhequr prej kredisë së shpërndarë në kategoritë e pranueshme do të ndjekë procedura të tilla të cilat do t'i specifikojë Shoqata duke njoftuar Huamarrësin. Tërheqje të tilla të mëtejshme do të bëhen vetëm pasi, dhe deri në atë masë që Shoqata do ta shikojë të arsyeshme që shuma të tilla, të mbetura në depozitë në llogarinë speciale deri në datën e një njoftimi të tillë, do të përdoren për të bërë pagesa për shpenzime të pranueshme.

6. (a) Nëse Shoqata do të përcaktonte në ndonjë rast që ndonjë pagesë nga llogaria speciale: (i) do të bëhej për një shpenzim ose në një shumë që nuk përputhet me paragrafin 2 të kësaj shtojce ose (ii) nuk justifikohet nga evidencat e paraqitura Shoqatës, Huamarrësit sapo të marrë njoftimin nga Shoqata: (A) do të sigurojë evidenca shtesë që mund të kërkojë Shoqata ose (B) do të depozitojë në llogarinë speciale (ose, nëse Shoqata do ta kërkojë, rifinancim për Shoqatën) një shumë të barabartë me shumën e një pagese të tillë apo pjesën jo aq të pranueshme apo të justifikuar. Përveçse kur Shoqata bie dakord ndryshe, nuk do të bëhet asnjë depozitë e mëtejshme nga Shoqata në llogarinë speciale, derisa Huamarrësi t'i sigurojë këto evidenca ose të bëjë një depozitim të tillë apo rifinancim, sipas rastit.

b) Nëse Shoqata në ndonjë rast ka përcaktuar se një shumë e papaguar në llogarinë speciale nuk do të kërkohej për të mbuluar pagesa të mëtejshme për shpenzimet e pranueshme, Huamarrësi, sapo të marrë njoftimin nga Shoqata, do t'i kthejë Shoqatës këtë shumë të papaguar.

c) Huamarrësi, me njoftim nga Shoqata, mund t'i kthejë asaj të gjitha ose një pjesë të fondeve të depozituara në llogarinë speciale.

d) Kthimet e bëra Shoqatës sipas paragrafit 6 (a), (b) dhe (c) të kësaj shtojce do t'i kreditohen llogarisë së kredisë për tërheqje të mëvonshme ose për anulim, në përputhje me dispozitat përkatëse të kësaj Marrëveshjeje, përfshirë kushtet e përgjithshme.

PËR RATIFIKIMIN E “MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE KOMUNITETIT EUROPIAN, PËR STATUSIN E MISIONIT TË ASISTENCËS POLICORE TË KOMUNITETIT EUROPIAN NË SHQIPËRI (PAMECA)”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Memorandumi i mirëkuptimit, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Komunitetit Europian, për statusin e Misionit të Asistencës Policore të Komunitetit Europian në Shqipëri (PAMECA)”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.4016, datë 2.12.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI,
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE KOMUNITETIT EUROPIAN,
PËR STATUSIN E MISIONIT TË ASISTENCËS POLICORE TË KOMUNITETIT EUROPIAN NË
SHQIPËRI (PAMECA)**

PREAMBUL

Duke marrë në konsideratë Marrëveshjen kuadër ndërmjet Komisionit të Komunitetit Europian (në vazhdim "Komisioni") dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, nënshkruar më 1 shtator 1992;

duke marrë në konsideratë kontratën e nënshkruar më 17 dhjetor 2002 ndërmjet Komisionit dhe Ministrisë së Brendshme të Spanjës, me synim vendosjen e Misionit të Asistencës Policore të Komunitetit Europian në Shqipëri (PAMECA);

duke pasur parasysh se Qeveria e Republikës së Shqipërisë ka rënë dakord për vendosjen e misionit PAMECA në Shqipëri;

duke pasur parasysh vendimin e Komisionit për t'ia besuar drejtimin operacional të këtij misioni Ministrisë së Brendshme të një prej shteteve anëtare të Bashkimit Europian, Spanjës, në ndjekje të kërkesës për shprehje interesi drejtuar të pesëmbëdhjetë shteteve anëtare dhe aplikimit të

marrë nga Spanja, si dhe të pranuar nga Komisioni;
duke pasur parasysh se një protokoll teknik do të konkludohet ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe misionit PAMECA dhe të miratuar nga Komisioni,
Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Komisioni i përfaqësuar nga kryetari i delegacionit të Komisionit European në Shqipëri, në vazhdim "Palët",
janë dakord si më poshtë:

Neni 1 Qëllimi dhe përkufizimet

1.1 Dispozitat e këtij memorandumi mirëkuptimi do të aplikohen për stafin ndërkombëtar civil, policor dhe gjyqësor të misionit PAMECA, si dhe për asetet e përfshira në këtë aktivitet.

1.2 Palët Kontraktuese mund të bëjnë rregullime të mëtejshme për të përcaktuar rregulla dhe procedura për këtë aktivitet, që do të kenë parasysh vazhdimësinë e tij.

1.3 Nëse nuk parashikohet ndryshe, dispozitat e këtij memorandumi mirëkuptimi dhe çdo angazhim i marrë nga autoritetet, si privilegjet, imunitetet, lehtësitë ose koncesionet që i garantohen misionit PAMECA ose çdo anëtar i tij në Republikën e Shqipërisë do të jenë të aplikueshme në Republikën e Shqipërisë.

1.4 Për qëllimet e këtij memorandumi mirëkuptimi, termat e mëposhtëm përkufizohen si vijon:

a) "PAMECA" do të thotë Misioni i Asistencës Policore të Komunitetit European për Shqipërinë, i vendosur në vijim të kontratës së nënshkruar ndërmjet Komisionit dhe Ministrisë së Brendshme të Spanjës, më 17 dhjetor 2002.

b) "Aktivitet" do të thotë mbështetje për përgatitje dhe pjesëmarrje në misionin PAMECA. Qëllimi i këtij misioni është të ndihmojë Policinë e Shtetit Shqiptar, shërbimet e prokurorisë dhe drejtësisë (përfshirë edhe Policinë Gjyqësore) në përmirësimin:

- e kapacitetit investigues dhe goditës në fushat kyçe të krimit të organizuar, menaxhimit të kufirit, rendit publik dhe sigurisë;
- e kooperimit të policisë me prokurorinë dhe sistemin gjyqësor;
- e menaxhim të burimeve njerëzore, financiare, materiale dhe të informacionit;
- e profesionalizmit dhe përgjegjshmërisë;
- e marrëdhënieve publike,

në mënyrë që të forcojë besimin e qytetarëve tek rendi publik dhe një shërbim policor demokratik e të paanshëm, si dhe tek një sistem drejtësie të pavarur. Në mënyrë që të përmirësojë punën e Policisë së Shtetit, shërbimeve të sistemit gjyqësor dhe prokurorisë, misioni PAMECA synon të zhvillojë trajnime, duke përfshirë edhe "trajnime në vendin e punës" dhe instruktive/këshillime të partnerëve shqiptarë, me të cilat janë dakord autoritetet shqiptare.

c) "Stafi i misionit PAMECA nga shtetet anëtare të BE-së" do të thotë stafi nga shtetet anëtare të BE-së që marrin pjesë në misionin PAMECA ose që mbikëqyrin projektet në kontekstin e funksioneve zyrtare të tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të stafit lokal (shqiptar) të punësuar.

d) "Stafi i shteteve anëtare të BE-së" do të thotë stafi civil, policor, gjyqësor i punësuar për qëllimet e misionit PAMECA nga shërbimet civile të shteteve anëtare të Bashkimit European ose i vënë në dispozicion në kontekstin e misionit PAMECA me detyra afatshkurtra. "Stafi gjyqësor" në këtë kontekst do të thotë gjyqtarë të punësuar për qëllimet e misionit PAMECA nga shtetet anëtare të Bashkimit European.

e) "Infrastrukturë" do të thotë të gjitha ambientet dhe trualli i nevojshëm që duhen për aktivitetet operacionale, si dhe për akomodimin e stafit të misionit PAMECA.

f) "Qeveria" do të thotë Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

g) "Të mirat materiale dhe asetet e stafit/ departamenteve të Komisionit European" do të thotë të mirat materiale dhe asetet që janë pronë e stafit, departamenteve dhe organizmave të Komisionit European dhe shteteve anëtare të tij ose që përdoren nga këto departamente dhe organizma, dhe që i jepen stafit të misionit PAMECA për kërkesat e operacioneve të tij.

h) "Selia e Komisionit" dhe "Përfaqësia e Komisionit" do të thonë respektivisht selia e Komisionit në Bruksel dhe delegacioni i Komisionit në Shqipëri.

Neni 2 **Mandati**

2.1 Misioni PAMECA do të synojë në dhënien e mbështetjes së vazhdueshme ndaj Policisë së Shtetit Shqiptar, kryesisht nëpërmjet sigurimit të vazhdimësisë së një sërë aktiviteteve që janë përgatitur ose janë zbatuar nga elementi policor këshillimor shumëkombësh i Unionit European Perëndimor (MAPE) dhe asistencës policore të Komisionit European (ECPA).

2.2 Misioni PAMECA, përveç aktiviteteve të tij, të përshkruara në termat e referencës (aneksi) që i bashkëngjiten kontratës së Komisionit me Ministrinë e Brendshme të Spanjës, do të këshillojë në hartimin e projekteve të tjera të Komisionit European të financuara nën programin CARDS në Shqipëri, (duke marrë parasysh aktivitetet e iniciuara nga misioni policor i mëparshëm ECPA, ose që janë rekomanduar nga ky i fundit) dhe do të sigurojë koordinimin e duhur me projektet e tjera, duke përfshirë edhe ato të financuara nga donatorë të tjerë. Në mënyrë që të përmbushë qëllimin e Misionit, siç është përshkruar në nenin 1.4, misioni PAMECA gjithashtu do të ndërmarrë aktivitete që lidhen me kooperimin ndërmjet shërbimeve policore dhe sistemit gjyqësor/prokurorisë dhe do të këshillojë koordinimin në zbatimin e projekteve të Komisionit European dhe të tjera në këtë sektor, brenda kornizës së përmendur më sipër dhe në kooperim me Ministrinë e Rendit Publik, Ministrinë e Drejtësisë dhe Prokurorinë e Përgjithshme.

2.3 Ministria e Rendit Publik, Ministria e Drejtësisë dhe misioni PAMECA do të marrin masat e duhura për të siguruar lidhje me koordinim të ngushtë reciprok në nivelet e duhura.

Neni 3 **Angazhimet e misionit PAMECA**

3.1 Misioni PAMECA në vazhdim angazhohet:

- a) të zbatojë aktivitetet e tij, në përputhje me mandatin sipas nenit 2;
- b) të raportojë rregullisht me shkrim pranë Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit European mbi aktivitetet dhe konstatimet e misionit PAMECA, duke përfshirë progresin e zbatimit në të gjitha fushat e aktivitetit të tij, si dhe përputhjen me iniciativat e tjera që kanë lidhje;
- c) të urdhërojë stafin e tij të mos detyrojnë zbatimin e ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe të frenohen nga çdo sjellje që bie ndesh me natyrën këshillimore të detyrave të tyre;

d) të ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm për të siguruar që anëtarët e stafit të tij, këshilltarët ose konsulentët në Shqipëri të mos përfshihen në aktivitete që bien ndesh me qëllimet dhe objektivat e misionit PAMECA apo me ligjet dhe rregulloret e Republikës së Shqipërisë;

e) si rezultat i konsultimeve të përbashkëta ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, Komisionit European dhe misionit PAMECA dhe me kërkesën e Qeverisë, të marrë përsipër largimin e çdo anëtari të stafit ndërkombëtar, këshilltari ose konsulenti, që përfshihet në shkelje serioze të ligjeve dhe rregulloreve të Republikës së Shqipërisë ose në çdo lloj aktiviteti që bie ndesh me qëllimin e misionit PAMECA;

f) të pajisë personelin e misionit PAMECA me kartë identiteti shërbimi, duke certifikuar statusin e tyre në misionin PAMECA dhe t'i japë qeverisë listën e personelit të misionit PAMECA, si dhe ta njoftojë atë për arritjen dhe largimin e personelit;

g) të punësojë staf lokal (shqiptar) për pozicione të përshtatshme në misionin PAMECA;

h) të sigurojë kushte të plota pune për partnerët e Ministrisë së Rendit Publik, Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme, që do të punojnë me misionin PAMECA.

Neni 4 **Angazhimet e qeverisë në lidhje me veprimtarinë e misionit PAMECA**

4.1 Në kuadrin e zbatimit të misionit PAMECA, Qeveria e Republikës së Shqipërisë, në vazhdim, është dakord dhe angazhohet:

a) të emërojë dhe të atashojë partnerë me përvojë, me kohë të plotë pune, për secilën nga fushat kryesore të veprimtarisë së misionit PAMECA, si goditja ndaj krimit, menaxhimi i burimeve

dhe sistemi gjyqësor e prokuroria;

b) të mundësojë ambiente pune të përshtatshme në Ministrinë e Rendit Publik (Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë), Ministrinë e Drejtësisë dhe Prokurorinë e Përgjithshme për ekspertët e misionit PAMECA;

c) të përjashtojë misionin PAMECA nga çdo lloj tatimi, takse doganore, taksash, taksa e vlerës së shtuar (TVSH) dhe detyrime të tjera, që janë aktualisht në fuqi dhe që mund të hyjnë në fuqi gjatë prezencës së misionit PAMECA në Shqipëri, për automjetet, mjetet e punës, materialet, pajisjet dhe artikuj të tjerë të importuar në Shqipëri ose të trashëguara nga misioni ECPA, përmendur në nenin 1 paragrafi 1.1 për përdorim zyrtar.

d) të garantojë livrimin imediat në rast importi ose eksporti në ose nga Shqipëria;

e) të përjashtojë nga çdo lloj tatimi, takse doganore, taksash, taksa e vlerës së shtuar (TVSH) dhe detyrime të tjera që janë aktualisht në fuqi dhe që mund të hyjnë në fuqi gjatë prezencës së misionit PAMECA në Shqipëri, pronat e misionit PAMECA të blera në vend, të ardhurat dhe të mirat e tjera materiale;

f) të përjashtojë misionin PAMECA nga çdo lloj ndalimi apo kufizimi mbi importin, importet dhe eksportet e përkohshme në lidhje me artikujt e importuar ose eksportuar nga misioni PAMECA për përdorim të tij zyrtar dhe në lidhje me publikimet e tij, në rast se artikujt në fjalë janë importuar ose eksportuar përpara zhdoganimit në doganë;

g) misioni PAMECA do të ketë të drejtën të dërgojë dhe të marrë korrespondencën e tij me korrier ose me pako, që do të kenë të njëjtat imunitete dhe privilegje si të korrierëve dhe pakove diplomatike;

h) misioni PAMECA do të ketë pacenueshmërinë e të gjitha letrave dhe dokumenteve që vijnë dhe dalin nga Shqipëria;

i) misioni PAMECA do të ketë të drejtën të importojë ose eksportojë përkohësisht automjetet e tij, sipas nevojës për përdorim të tij, pa qenë subjekt i regjistrimit të detyrueshëm ose licencimit, ose siguracionit komercial;

j) të pranojë si të vlefshme, pa taksë ose tatim, licencat e drejtuesit të automjetit dhe licencat dhe lejet e tjera që u janë lëshuar anëtarëve të stafit të misionit PAMECA nga autoritetet kombëtare respektive të tyre;

k) të përjashtojë misionin PAMECA nga detyrimet doganore mbi importin, importin dhe eksportin e përkohshëm të publikimeve të misionit PAMECA, duke përfshirë filmime dhe fotografi, regjistrime zanore, programe kompjuterike dhe baza të dhënash, që kanë lidhje me aktivitetet e misionit PAMECA;

l) të ndihmojë misionin PAMECA dhe anëtarët e stafit të tij, këshilltarët dhe konsulentët me detyrë në Shqipëri në kryerjen e detyrave në Shqipëri, si dhe t'i pajisë ata me karta identiteti ose dokumente të tjera të përshtatshme, në mënyrë që të lehtësojë kryerjen e detyrave të tyre në Shqipëri;

m) të autorizojë misionin PAMECA të operojë me llogari bankare në monedhë të huaj dhe të kryejë operatione të tilla që mund të kërkohen për të plotësuar në mënyrë të kënaqshme aktivitetet e tij ndërkombëtare, brenda rregullave dhe kontrollit të shkëmbimit, gjatë kohës që janë në fuqi në Shqipëri;

n) të ndihmojë, ku ka mundësi, që të sigurojë funksionimin e mirë të komunikimit zyrtar të misionit PAMECA;

o) të lejojë misionin PAMECA të operojë çdo lloj komunikimi me pajisje radio dhe satelit;

p) t'i japë misionit PAMECA dhe stafit të tij ndërkombëtar dhe lokal, automjeteve, pajisjeve, materialeve dhe pajisjeve personale mbrojtjen e kërkuar falas, në rast se mund të dalin nevoja të tilla;

q) të përjashtojë misionin PAMECA nga çdo lloj tatimi, takse doganore, TVSH, dhe detyrime të tjera që janë në fuqi gjatë prezencës së misionit PAMECA në Shqipëri për automjetet, materialet, pajisjet dhe artikujt e tjerë që janë importuar në Shqipëri nga misioni PAMECA për përdorim zyrtar, që kanë humbur, janë vjedhur ose prishur gjatë ekzekutimit të mandatit të tij në Shqipëri. Në rast se misioni PAMECA vendos të përforcojë strukturat publike qendrore ose lokale duke dhuruar pjesë të caktuara të pronës së tij, të njëjtat rregulla do të aplikohen;

r) të lejojë misionin PAMECA të ekspozojë sipas nevojës flamurin e Bashkimit Europian dhe emblemën.

Neni 5

Privilegjet dhe imunitetet e misionit PAMECA dhe stafit të tij

5.1 Qeveria angazhohet të respektojë natyrën ekskluzivisht ndërkombëtare të misionit PAMECA. Gjatë aktiviteteve që do të kryejë në Shqipëri, misioni PAMECA dhe stafi i tij do të kontaktojnë autoritetet kompetente të rendit publik, shërbimit policor, si dhe autoritetet e prokurorisë dhe gjyqësorit të Republikës së Shqipërisë dhe do të koeporojë me to.

5.2 Qeveria angazhohet të njohë dhe të respektojë statusin e plotë diplomatik të misionit PAMECA, që rrjedh nga dispozitat e Konventës së Vjenës për marrëdhëniet diplomatike të 18 prillit 1961, që do të aplikohet *mutatis mutandis* për stafin e misionit PAMECA. Të gjitha të mirat materiale dhe asetet e Komisionit European dhe stafi/departamentet e shteteve anëtare të Komisionit European të pranishme në Shqipëri, në kontekstin e veprimtarisë së misionit, do të gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e përcaktuara në Konventën e lartpërmendur dhe në këtë memorandum mirëkuptimi.

5.3 Privilegjet dhe imunitetet e përmendura në këtë nen dhe në nenin 6 do t'i garantohen anëtarëve ndërkombëtarë të stafit të misionit PAMECA gjatë misionit të tyre e në vazhdim, përsa i përket veprimeve të kryera gjatë misionit të tyre.

5.4 Misioni PAMECA dhe stafi i tij duhet të frenohen nga çdo lloj veprimi ose aktiviteti që bie ndesh me natyrën ndërkombëtare dhe të paanshme të detyrës së tyre ose me frymën e këtij memorandum mirëkuptimi. Ata duhet të veprojnë në përputhje me ligjet dhe rregulloret e Republikës së Shqipërisë. Shefi i misionit PAMECA do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që këto obligime të respektohen.

5.5 Për aq sa janë të aplikueshme, dispozitat e këtij neni dhe të neneve 6 dhe 7 që vijojnë do t'i referohen edhe anëtarëve të familjeve të stafit të misionit PAMECA gjatë qëndrimit të tyre në Shqipëri.

Neni 6

Angazhimet e qeverisë në lidhje me anëtarët e stafit, këshilltarët dhe konsulentët e misionit PAMECA

6.1 Në lidhje me shefin e misionit PAMECA, anëtarët e stafit, këshilltarët, konsulentët dhe personelin tjetër të misionit PAMECA që nuk janë shtetas të Republikës së Shqipërisë ose rezidentë në Shqipëri, ekskluzivisht në përputhje me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje, Qeveria e Republikës së Shqipërisë angazhohet:

a) të garantojë përjashtimin nga të gjitha llojet e tatimeve, taksave mbi të ardhurat, dhe detyrimeve të tjera, si dhe kontributeve për sistemet e sigurimeve shoqërore;

b) të përjashtojë nga pagesa e taksave, tatimeve dhe detyrimeve të tjera gjatë përdorimit të aeroportëve dhe shërbimeve aeroportuale, rrugore dhe portuale;

c) të përjashtojë nga pagesa e detyrimeve doganore, të importit dhe detyrimeve të tjera për mallrat e përdorimit personal të reja ose të përdorura, për pajisjet shtëpiake dhe për çdo lloj pajisje për përdorim personal; në rast se mallra dhe pajisje të tilla shiten ose ndërrojnë pronësi në Shqipëri, përveç rasteve kur i kalojnë personave ose organizatave me të njëjtat privilegje, atëherë tatimet dhe taksat do të paguhën në përputhje me dispozitat përkatëse.

d) të garantojë përjashtimin e tyre nga shërbimet e detyrueshme kombëtare, regjistrimet e të huajve dhe kufizimet e emigracionit;

e) të mundësojë lehtësi të tilla riatdhesimi në kohë krize, siç mundësohen nga qeveria për personelin e asistencës teknike;

f) të lejojë ata ose personat në varësi të tyre të sjellin në Shqipëri një sasi të arsyeshme monedhe të huaj për përdorim personal, të tërheqin dhe të riatdhesojnë sasi të tilla nga Shqipëria nëpërmjet llogarive bankare, në përputhje me rregullat e shkëmbimit valutor në Shqipëri;

g) të garantojë për ta lirinë e udhëtimit, lëvizjes dhe komunikimit brenda territorit të Shqipërisë, si dhe hyrjen dhe daljen e lirë në dhe nga Shqipëria;

h) stafi ndërkombëtar i misionit PAMECA do të gëzojë paprekshmërinë personale nga juridiksioni penal, juridiksioni civil dhe administrativ.

6.2 Anëtarët e stafit, këshilltarët, konsulentët dhe personeli tjetër i misionit PAMECA që janë

shtetas ose rezidentë në Shqipëri:

i) do të kenë imunitet ndaj procesit ligjor në lidhje me fjalët e thëna ose të shkruara dhe të gjitha aktet e tjera të kryera nga ata në funksionin e tyre zyrtar.

Neni 7 **Juridiksioni**

7.1 I gjithë stafi i misionit PAMECA do të gëzojë imunitet ndaj proceseve ligjore në lidhje me veprimet e kryera gjatë funksionit të tyre zyrtar (përfshirë të folura dhe të shkruara). Ata do të vazhdojnë ta gëzojnë këtë imunitet, që mbulon veprimet e identifikuar në fjalinë pararendëse, kur të kenë pushuar së qeni anëtarë të, ose të punësuar nga misioni PAMECA, edhe pasi të gjitha dispozitat e tjera të këtij memorandum mirëkuptimi të kenë pushuar së aplikuari.

7.2 Si ekspertë në mision, stafi i misionit PAMECA do të gëzojë imunitet ndaj arrestit dhe ndalimit. Stafi i misionit PAMECA që arrestohet apo ndalohet gabimisht, duhet t'i dorëzohet menjëherë autoriteteve të misionit PAMECA.

7.3 Në qoftë se qeveria konsideron se një anëtar i misionit PAMECA ka kryer një akt kriminal, ajo duhet që menjëherë të informojë shefin e misionit PAMECA dhe të paraqesë çdo fakt që mund të ketë për këtë akt.

7.4 Sipas dispozitave të nenit 3, çdo anëtar i stafit të misionit PAMECA, në çdo rrethanë dhe në çdo kohë, përgjigjet vetëm përpara përfaqësuesit të tij kombëtarë për çdo akt kriminal ose shkelje të ligjit që ata mund të kryejnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur vendi i tyre vendos, për shkak të natyrës së shkeljes, të mos ushtrojë autoritetin e tij, por t'ia transferojë atë qeverisë, bazuar në një procedurë ekstradimi.

7.5 Autoritetet e Republikës së Shqipërisë dhe misioni PAMECA do t'i japin njeri-tjetrit ndihmën reciproke për të ushtruar të drejtat dhe obligimet e tyre respektive. Vendet pjesëmarrëse do të informojnë Qeverinë për çdo proces ligjor kundër anëtarëve të misionit PAMECA që kanë kryer një akt kriminal.

Neni 8 **Ambientet e nevojshme për aktivitetet administrative dhe operacionale të misionit PAMECA dhe akomodimi i stafit: imunitetet e ambienteve të misionit PAMECA**

8.1 Vetëm shefi i misionit PAMECA mund të autorizojë përfaqësuesit e autoriteteve publike ose këdo tjetër që nuk i përket misionit PAMECA që të hyjë më ambientet e misionit.

8.2 Në rast se lind nevoja, misioni PAMECA ka të drejtën të prodhojë energji elektrike në ambientet e tij për nevojat e tij, si dhe ta transmetojë e ta shpërndajë atë.

8.3 Misioni PAMECA autorizohet të ekspozojë sipas nevojës flamurin e Bashkimit European dhe emblemën.

Neni 9 **Pretendimet për kompensim dhe procedurat ligjore**

9.1 Nëse stafi i misionit PAMECA ose prona e tij cenohen ose dëmtohen nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, stafi i saj apo nga shtetasit shqiptarë, çdo vend që kontribuon në misionin PAMECA, me përjashtim të rasteve serioze dhe të qëllimshme, mund të tërheqë pretendimet për kompesim dhe rimbursim të dëmtimeve.

9.2 Kërkesat për kompensim për cenimet e shkaktuara ose dëmtimet e shkaktuara ndaj stafit ose pronës së Qeverisë, ose shtetasve shqiptarë dhe pronës së tyre, do të dërgohen nëpërmjet autoriteteve shqiptare tek shefi i misionit PAMECA dhe do të zgjidhen si më poshtë:

a) Procedurat, në lidhje me pretendimet për kompensim dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve që mund të dalin si pasojë e akteve apo ngjarjeve të shkaktuara nga misioni PAMECA ose anëtarët e tij, në dëm të Republikës së Shqipërisë ose të shtetasve shqiptarë, ose personave juridikë, si dhe procedurat për pretendimet e misionit PAMECA për kompensim, do të përcaktohen në një marrëveshje të veçantë.

b) Pretendimet për kompensim që ngrihen si pasojë e aktiviteteve të lidhura me trazirat civile, mbrojtjen e misionit PAMECA, shkarkimin e armëve ose nevoja operacionale (si p.sh. aktiviteteve që sigurojnë mbështetjen ose zbatimin e operacionit dhe pjesëmarrjen e misionit PAMECA dhe stafit të tij në këtë operacion, që janë të nevojshme për mbrojtjen e misionit PAMECA) nuk do të pranohen dhe nuk do të çojnë në pagesën e kompensimit.

c) Nëse një veprim civil dërgohet në një gjykatë shqiptare, kundër anëtarëve të misionit PAMECA, shefi i misionit PAMECA duhet të njoftohet menjëherë dhe ai duhet t'i vërtetojë gjykatës, nëse çështja ka ose nuk ka lidhje me funksionet ose detyrat zyrtare të personit në fjalë.

d) Nëse shefi i misionit PAMECA vërteton që veprimi civil i paraqitur ka lidhje me detyrat dhe funksionet zyrtare, çështja do të mbyllet. Në rast të kundërt, kur mosmarrëveshjet ose kërkesat për kompensim mbulohen nga ligji privat ku misioni PAMECA ose anëtarët e tij bëjnë pjesë dhe ku gjykatat shqiptare nuk kanë autoritet sipas dispozitave të këtij memorandum mirëkuptimi, ato do të zgjidhen nga një komision i posaçëm, i ngritur për këtë qëllim, sipas një vendimi të marrë në bazë të nenit 1.2.

e) Nëse shefi i misionit PAMECA vërteton që veprimi i paraqitur nuk ka lidhje me detyrat dhe funksionet zyrtare, procedimi mund të vazhdojë. Nëse shefi i misionit PAMECA vërteton që një anëtar i misionit PAMECA nuk është në gjendje të mbrojë interesat e tij përgjatë procedimit, për shkak të funksioneve të tij zyrtare ose për shkak të një mungese të autorizuar, gjykata do të ndërpresë procedimin deri sa ai të mund të mbrojë veten e tij, por jo për më shumë se 90 (nëntëdhjetë) ditë. Prona e një anëtarit të tillë të misionit PAMECA, e cila vërtetohet nga shefi i misionit PAMECA si e nevojshme për ekzekutimin e detyrave të tij funksionale zyrtare nuk do të merret, në zbatim të një gjykimi ose vendimi të gjykatës. Nëse një veprim civil paraqitet, nuk do të ketë kufizime të lirisë personale të një anëtarit të misionit PAMECA, as në rast të zbatimit të një gjykimi ose vendimi të gjykatës, për administrimin e një betimi ose për çdo arsye tjetër.

Neni 10

Dispozitat, pajisja me të mira materiale dhe shërbime, shëndeti dhe kushtet sanitare

10.1 Misioni PAMECA do të përjashtohet nga taksat e përgjithshme të shitjes, në lidhje me blerjet e saj zyrtare në Republikën e Shqipërisë.

10.2 Misioni PAMECA dhe Qeveria do të bashkëpunojnë për shërbimet shëndetësore dhe në mënyrë të plotë për çështjet në lidhje me shëndetin, në mënyrë të veçantë në kontrollin e sëmundjeve ngjitëse në përputhje me konventat ndërkombëtare.

10.3 Misioni PAMECA do të autorizohet të konkludojë kontrata të drejtpërdrejta me ofruesit e të mirave materiale dhe shërbimeve në Republikën e Shqipërisë, i përjashtuar nga të gjitha taksat dhe tatimet.

Neni 11

Komunikimi

11.1 Qeveria njeh dhe pranon që operacioni kërkon përdorimin e mjeteve të komunikimit. Misioni PAMECA do të autorizohet të përdorë postën e tij të brendshme dhe shërbimet e telekomunikacionit.

11.2 Ky autorizim do të përfshijë të drejtën për të përdorur sisteme të nevojshme të informacionit dhe të komunikimit për të garantuar një kapacitet të plotë komunikimi, si dhe të drejtën për të përdorur spektrin e plotë elektromagnetik pa pagesë për këtë qëllim. Në ushtrimin e të drejtave të tij, misioni PAMECA do të bëjë çdo gjë të arsyeshme brenda limiteve të saj për të koordinuar me autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë dhe për të marrë parasysh nevojat dhe kërkesat e tyre. Autoritetet shqiptare do të ndihmojnë shefin e misionit PAMECA në rastet kur ai ka nevojë të përdorë sistemet lokale të informacionit dhe komunikimit (qarqe, pajisje, faks dhe telefon).

Neni 12

Bashkëpunimi dhe ndërlidhja

12.1 Qeveria dhe shefi i misionit PAMECA do të marrin masat e duhura për të bashkëpunuar

dhe komunikuar ngushtë dhe reciprokisht me njëri-tjetrin dhe në nivelet e duhura.

Neni 13

Mosmarrëveshjet

13.1 Çdo lloj mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose aplikimin e këtij memorandum mirëkuptimi, e cila nuk mund të zgjidhet me anë të negociatave direkte, do të zgjidhet ekskluzivisht nëpërmjet kanaleve diplomatike ndërmjet Shqipërisë dhe Komisionit, përveç rasteve për të cilat është rënë dakord.

13.2 Mosmarrëveshjet në lidhje me kushtet e punësimit dhe të shërbimit të stafit të punësuar lokal do të zgjidhen me anë të procedurave administrative, të cilat do të përcaktohen nga shefi i misionit PAMECA dhe autoritetet shqiptare.

Neni 14

Dispozitat përfundimtare

14.1 Qeveria e Shqipërisë do të pranojë përgjegjësinë ligjore për të gjitha aktivitetet e misionit PAMECA dhe për personelin e saj, të cilat kryhen në bazë të këtij memorandum mirëkuptimi, si edhe për ndonjë veprim të ndërmarrë në mënyrë direkte ose jodirekte në përgjigje të raporteve ose rekomandimeve të misionit PAMECA ose personelit.

14.2 Qeveria e Shqipërisë do t'i sigurojë Komisionit European të gjithë informacionin në lidhje me aplikimin e këtij memorandum mirëkuptimi dhe, kur të jetë e nevojshme, do të ofrojë bashkëpunimin e plotë, mbrojtjen dhe asistencën e nevojshme për plotësimin e detyrave të misionit PAMECA, siç është specifikuar në këtë memorandum mirëkuptimi.

14.3 Ky memorandum mirëkuptimi do të hyjë në fuqi në datën e njoftimit nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, me anë të të cilit thuhet se janë përfunduar procedurat e brendshme ligjore që kërkojnë për hyrjen në fuqi të tij.

14.4 Ky memorandum mirëkuptimi do të mbesë në fuqi deri në atë kohë që Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose Komisioni European do të njoftojë palën tjetër, 60 ditë përpara, për synimin e përfundimit të këtij memorandum mirëkuptimi.

14.5 Sa herë që ky memorandum mirëkuptimi i referohet privilegjeve, imuniteteve dhe detyrave të misionit PAMECA dhe stafit të tij apo lehtësirave të cilat i ndërmerr Qeveria për t'i bërë të vlefshme për misionin PAMECA, Qeveria do të ketë përgjegjësi të plotë për të siguruar që këto privilegje, imunitete, të drejta dhe lehtësira zbatohen dhe aplikohen nga autoritetet kompetente lokale në Republikën e Shqipërisë.

14.6 Secila palë e këtij memorandum mirëkuptimi mund të propozojë amendamente për cilëndo nga dispozitat e tij. Këto amendamente do të hyjnë në fuqi me pranimin me shkrim nga Republika e Shqipërisë dhe Komisioni European.

14.7 Ky memorandum mirëkuptimi nënshkruhet në gjuhët angleze dhe shqipe, në 4 (katër) kopje origjinale për secilën:

2 (dy) kopje në anglisht dhe 2(dy) kopje në shqip mbahen nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe

2 (dy) kopje në anglisht dhe 2(dy) kopje në shqip mbahen nga Komisioni European.

14.8 Ky memorandum mirëkuptimi është vazhdim i memorandumit të mirëkuptimit, nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe misioni ECPA dhe zëvendëson këtë të fundit, jo më vonë se nga dita e nënshkrimit prej të dyja Palëve.

14.9 Në rast të një misioni të ri nën Komisionin European pas misionit PAMECA, ky memorandum do të jetë i aplikueshëm për misionin e ri, për aq kohë sa karakteri i misionit mbetet i njëjtë dhe Palët nuk kanë kundërshtim.

14.10. Ky memorandum mirëkuptimi konsiston në 14 (katërmëdhjetë) faqe dhe nënshkruhet nga të dyja Palët në Tiranë, më 15.7.2003.

Në dëshmi të të cilës, të plotfuqishmit e referuar më poshtë kanë nënshkruar këtë memorandum mirëkuptimi.

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë

Për Komisionin European

MINISTRI I RENDIT PUBLIK
Luan Rama

DREJTORI PËR EUROPEË-AID
Për B.Knudsen

MINISTRI I DREJTËSISË
Spiro Peçi

L I G J
Nr.9153, datë 6.11.2003

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8167, DATË 21.11.1996 “PËR SHËRBIMIN SHËNDETËSOR STOMATOLOGJIK”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8414, DATË 1.10.1998

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8167, datë 21.11.1996 “Për shërbimin shëndetësor stomatologjik”, ndryshuar me ligjin nr.8414, datë 1.10.1998, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 10, pas shkronjës “c” shtohet shkronja "ç" me këtë përmbajtje:

“ç) për kualifikimin e specializimin e specialistëve të mesëm e të lartë dhe për hapjen e shkollave profesionale që përgatisin specialistë të fushës së stomatologjisë, sipas legjislacionit për arsimin dhe formimin profesional.”.

Neni 2

Pas nenit 10 shtohet neni 10/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 10/1

Personat juridikë dhe fizikë, vendas e të huaj, që janë të pajisur me licencë profesionale, sipas shkronjës “c” të nenit 10 të këtij ligji, për çdo importim të bërë, pajisen me leje importi për materiale dhe aparatura dentare nga Ministria e Shëndetësisë. Licenca e importit është automatike.

Ministri miraton rregulloren përkatëse.”.

Neni 3

Neni 11 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 11

Shërbimi shëndetësor stomatologjik, publik dhe privat, kontrollohet nga Inspektorati Stomatologjik Shtetëror."

Neni 4

Pas kreut III shtohet kreu III/1 me këtë përmbajtje:

"KREU III/1
STRUKTURAT E KONTROLLIT TË SHËRBIMIT STOMATOLOGJIK

Neni 14/1

Në varësi të Ministrit të Shëndetësisë krijohet Inspektorati Stomatologjik Shtetëror, si organi më i lartë i kontrollit stomatologjik. Struktura, rregullat e funksionimit të Inspektoratit Stomatologjik Shtetëror, në nivel qendror dhe vendor, miratohen nga Ministri i Shëndetësisë.

Neni 14/2

Inspektorati Stomatologjik Shtetëror është organi ekzekutiv i specializuar, që kontrollon zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në shërbimin stomatologjik publik dhe privat.

Neni 14/3

Inspektorati Stomatologjik Shtetëror, në kryerjen e detyrave të tij, bashkëpunon me:
Inspektoratin Sanitar Shtetëror;
Inspektoratin Epidemiologjik;
Komisionin e Mbrojtjes nga Rrezatimet.
Koordinimi i punës së këtyre organeve bëhet me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.4017, datë 2.12.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

**L I G J
Nr.9154, datë 6.11.2003**

PËR ARKIVAT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

KREU I OBJEKTI DHE PËRKUFIZIME

Neni 1

Ky ligj përcakton rregullat bazë për organizimin e funksionimin e shërbimit arkivor në Shqipëri, institucionet që kryejnë këtë shërbim, si dhe detyrimet e tyre ligjore për krijimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e pasurisë arkivore, si pjesë e trashëgimisë kombëtare.

Neni 2

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Arkiva” janë institucionet shtetërore ose joshetërore të specializuara, që mbledhin, përpunojnë, administrojnë, ruajnë dhe shërbejnë pasurinë arkivore, e cila mbrohet dhe sigurohet nga shteti. Arkiva janë edhe njësitë strukturore e nënstrukturore të institucioneve të administratës shtetërore qendrore e vendore, që evidencojnë, ruajnë, përpunojnë dhe vënë në shfrytëzim dokumentet e krijuara prej tyre.

2. “Arkiv” është çdo pasuri dokumentare që ruhet prej institucioneve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, si dhe çdo pasuri dokumentare e krijuar ose e ruajtur prej subjekteve joshetërore, juridike e fizike private.

3. “Autoritet publik” janë organet përfaqësuese të pushtetit qendror dhe vendor; institucionet e administratës, qendrore dhe vendore të pushteteve kushtetuese; personat juridikë dhe fizikë, në masën që ata përmbushin funksione publike ose ushtrojnë një detyrë administrative, sipas ligjeve në fuqi.

4. “Dokumente me rëndësi historike kombëtare” janë të gjitha aktet që kanë vlerë ruajtjeje të përhershme dhe shpallen si të tilla nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, për shkak të rëndësisë juridiko-administrative, historike, shkencore dhe kulturore për trashëgiminë e popullit shqiptar.

5. “Dokumente” janë të gjitha aktet e krijuara nga autoritetet publike, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre në funksione administrative; aktet e krijuara nga institucionet joshetërore, si dhe subjektet juridike e fizike private, kur vlerësohen me rëndësi historike kombëtare.

6. “Fondi arkivor kombëtar” është e gjithë pasuria dokumentare, shtetërore e joshetërore, me vlerë ruajtjeje të përhershme ose të përkohshme, në administrim të arkivave shtetërore a privatë.

7. “Kërkues” është personi që ka paraqitur një kërkesë me shkrim për shërbim arkivor, e cila i është miratuar, me përjashtim të vetë personelit të brendshëm të arkivave.

8. “Komunikim” është detyrimi ligjor i arkivave shtetërore për të vënë në dispozicion dhe për t’u shërbyer institucioneve dhe individëve dokumentet që ato ruajnë dhe përmbushja e kësaj përgjegjësie ligjore.

9. “Rrjet arkivor” është tërësia e institucioneve në varësi të drejtpërdrejtë, si dhe e atyre që kanë varësi metodologjike-profesionale nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, përshkruar sipas nenit 9 të këtij ligji.

10. Shfrytëzim i arkivave” është mundësia e përdorimit të dokumenteve arkivore, në funksion të njohjes me veprimtarinë e administratës shtetërore dhe e drejta për shërbim me dokumente për qëllime studimore-shkencore ose për nevoja vetjake.

KREU II FONDI ARKIVOR KOMBËTAR

Neni 3

1. Fondi arkivor kombëtar është tërësia e dokumenteve të krijuara, të dërguara dhe të pranuara, gjatë veprimtarisë së institucioneve shtetërore ose joshetërore, të personave juridikë e fizikë privatë, pavarësisht nga koha, vendi, pronësia, mënyra e krijimit dhe lloji i tyre, me vlerë historike kombëtare juridike, politike, ekonomike, sociale e kulturore.

2. Emërtimi i dokumenteve, që përbëjnë fondin arkivor kombëtar, shpallet nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe është i njësuar në të gjithë rrjetin arkivor të vendit.

Neni 4

Në fondin arkivor kombëtar bëjnë pjesë edhe dokumentet e krijuara nga institucionet e administratave shtetërore të huaja, që kanë vepruar në hapësirën historike shqiptare para shpalljes së Pavarësisë, si dhe dokumentet e organizatave, shoqërive dhe personaliteteve shqiptare, që e kanë ushtruar veprimtarinë e tyre jashtë shtetit.

Neni 5

1. Fondi arkivor kombëtar dhe arkivat mbrohen dhe sigurohen nga shteti, sipas kërkesave të këtij ligji.

2. Shteti shqiptar njeh detyrimet për mbrojtjen e trashëgimisë dokumentare, që rrjedhin nga aktet juridike ndërkombëtare, ku ai është palë nënshkruese.

Neni 6

1. Dokumentet e subjekteve shtetërore e joshtetërore, si dhe të personave juridikë e fizikë privatë, që janë bërë pjesë e fondit arkivor kombëtar para hyrjes në fuqi të ligjit nr.7726, datë 29.6.1993 “Për fondin arkivor dhe për arkivat”, janë të pakthyeshme, pavarësisht nga mënyra e hyrjes në arkivat shtetërorë, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në marrëveshjen e pranimit.

2. Dokumentet që përbëjnë fondin arkivor kombëtar nuk dalin jashtë vendruajtjes së përhershme, përveç rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe. Në ato raste kur dokumenti del jashtë vendruajtjes, shoqërohet nga një punonjës i autorizuar i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Pas përfundimit të veprimeve procedurale të domosdoshme, dokumenti kthehet në vendruajtjen e përhershme dhe nëse është e nevojshme përdoret përsëri sipas së njëjtës procedurë.

Neni 7

1. Përcaktimi i vlerës dhe i afateve të ruajtjes së dokumenteve të arkivave në veprim të institucioneve shtetërore bëhet nga komisionet e ekspertizës, që funksionojnë pranë këtyre institucioneve. Vendimet e tyre miratohen nga komisionet e ekspertizës, që funksionojnë pranë arkivave respektivë të një shkalle më lart, të përshkruar sipas nenit 9 të këtij ligji.

2. Asgjësimi i dokumenteve, që e humbasin vlerën e ruajtjes, bëhet nga institucionet që i kanë ato në administrim, sipas rregullave të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Neni 8

Institucionet shtetërore ose joshtetërore, si dhe personat juridikë e fizikë privatë që kanë dokumente të shpallura me rëndësi historike kombëtare, janë të detyruara të dërgojnë të dhëna informuese për efekt regjistrimi në arkivat shtetërorë respektivë, të përshkruar në nenin 9 shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “d” të këtij ligji.

KREU III ORGANIZIMI I RRJETIT ARKIVOR

Neni 9

1. Fondi arkivor kombëtar ruhet, përpunohet, administrohet dhe shërbehet nga rrjeti arkivor i Republikës së Shqipërisë.

2. Rrjeti arkivor i Republikës së Shqipërisë përbëhet nga:
 - a) Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave;
 - b) Arkivi Qendror Shtetëror;
 - c) arkivat shtetërorë që ruajnë dokumente të së njëjtës tipologji (Arkivi Qendror i Filmit, Arkivi Qendror Teknik);
 - ç) arkivat shtetërorë të sistemit, që funksionojnë në mënyrë të përhershme pranë institucioneve qendrore fondkrijuese;
 - d) arkivat shtetërorë vendorë;
 - dh) arkivat në veprim të institucioneve shtetërore, qendrore dhe vendore;
 - e) arkivat privatë.
3. Krijimi i arkivave të rinj shtetërorë, sipas pikës 2 shkronjat “c” dhe “ç” të këtij neni, bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 10

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave është organi më i lartë i rrjetit arkivor kombëtar. Ajo është institucion qendror në varësi të Kryeministrit.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave është person juridik. Ajo ka vulën dhe stemën e vet. Selia e saj ndodhet në Tiranë.
3. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave përfaqësohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili emërohet dhe lirohet nga detyra prej Kryeministrit.

Neni 11

1. Drejtori i Përgjithshëm është titullari i institucionit. Ai kryen këto detyra:
 - a) përgjigjet përpara Këshillit të Ministrave për veprimtarinë e institucionit;
 - b) miraton rregullore, urdhra dhe udhëzime të detyrueshme për zbatim, në mbështetje të legjislacionit arkivor;
 - c) miraton planet vjetore të drejtorive që funksionojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme dhe ato të drejtorive të arkivave shtetërorë vendorë;
 - ç) përfaqëson arkivat shtetërorë të vendit në organizmat dhe institucionet ndërkombëtare ku ato janë anëtarësuar dhe ushtron të drejtën e votës në emër të tyre.
2. Drejtori i Përgjithshëm kryen detyra të tjera të parashikuara nga Rregullorja e Organizimit dhe Funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.

Neni 12

1. Nëpunësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, drejtuesit, specialistët dhe arkivistët, gëzojnë statusin e nëpunësit civil, ndërsa për punonjësit e tjerë zbatohet legjislacioni i Kodit të Punës.
2. Rekrutimi i punonjësve, mënyra e pranimi, lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe largimit bëhet sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.
3. Punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, të cilët, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë në vende pune që konsiderohen pjesë e shërbimit civil, janë nëpunës në periudhë prove për 1 vit.

Neni 13

1. Në varësi të drejtpërdrejtë administrative të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave janë Arkivi Qendror Shtetëror dhe arkivat shtetërorë vendorë.
2. Arkivat e tjerë, që bëjnë pjesë në rrjetin arkivor kombëtar, të përshkruar në nenin 9 shkronjat “c”, “ç”, “dh” dhe “e”, kanë varësi metodologjike-profesionale nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Neni 14

1. Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave funksionojnë: Këshilli i Lartë i Arkivave, Komisioni Qendror i Ekspertizës, Komisioni i Deklasifikimit dhe i Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” dhe Komisioni i Përhershëm i Ekspertëve të Vlerësimit të Dokumenteve me Rëndësi Historike Kombëtare.

2. Këshilli i Lartë i Arkivave harton dhe miraton politikat arkivore dhe strategjinë e zhvillimit të shërbimit arkivor.

3. Komisioni Qendror i Ekspertizës shqyrton dhe miraton listat e dokumenteve për asgjësim, sipas vendimit të propozuar prej komisioneve të ekspertizës, që funksionojnë pranë institucioneve shtetërore, të cilat i dorëzojnë dokumentet e tyre në Arkivin Qendror Shtetëror.

4. Komisioni i Deklasifikimit e i Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” bën deklasifikimin e dokumenteve, që kanë hyrë të klasifikuara në Arkivin Qendror Shtetëror dhe në arkivat shtetërore vendore, para hyrjes në fuqi të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””.

5. Statusi, rregullat, përbërja dhe shpërblimi i anëtarëve të Këshillit të Lartë të Arkivave, të Komisionit Qendror të Ekspertizës, të Komisionit të Deklasifikimit e të Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” dhe të Komisionit të Përhershëm të Ekspertëve për Vlerësimin e Dokumenteve me Rëndësi Historike Kombëtare, miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 15

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave harton normën tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor dhe organizon, drejton e kontrollon zbatimin e njësuar të saj në veprimtarinë e të gjithë rrjetit arkivor të vendit.

2. Për krijimin e normës tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave mbështetet në legjislacionin e vendit dhe në aktet e marrëveshjet themelore ndërkombëtare, të pranuar në rang ndërkombëtar, në këtë ligj dhe në Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

3. Rregullat e miratuara prej kësaj drejtorie, në mbështetje dhe në zbatim të këtij ligji, janë të detyrueshme për zbatim në të gjithë rrjetin arkivor të vendit.

Neni 16

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ushtron të drejtën e përfaqësimit dhe të votës, në emër të shtetit shqiptar, në organizatat ndërkombëtare ku është anëtare.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave nënshkruan marrëveshje dy ose shumëpalëshe me institucionet respektive të vendeve të tjera për pasurimin e fondit arkivor kombëtar, për publikimin, shkëmbimin e përvojave, përgatitjen dhe kualifikimin e specialistëve.

Neni 17

Arkivi Qendror Shtetëror ruan, përpunon, administron dhe shërben:

- a) dokumentet që janë trashëguar nga shteti shqiptar nga periudha parashetërore;
- b) dokumentet që janë krijuar nga institucionet qendrore e vendore të administratës shtetërore deri në vitin 1944;
- c) dokumentet e institucioneve qendrore të administratës shtetërore dhe të organeve udhëheqëse partiake, të krijuara deri në vitin 1991;
- ç) dokumentet e institucioneve qendrore të administratës shtetërore pa kufizim kohor, me përjashtim të atyre që ruhen në arkivat e sistemit ose në arkivat që ruajnë akte të së njëjtës tipologji;
- d) dokumentet që janë krijuar prej institucioneve të tjera shtetërore joqendrore pas vitit 1944, por janë të vetme në llojin e tyre;
- dh) dokumentet që janë krijuar prej subjekteve e personave juridikë dhe fizikë privatë, të kaluara në pronësi të shtetit para hyrjes në fuqi të ligjit nr.7726, datë 29.6.1993 “Për fondin arkivor kombëtar dhe për arkivat”.

Neni 18

Arkivi Qendror Shtetëror ruan, administron dhe shërben trashëgiminë dokumentare joadministrative, të krijuar në hapësirën shqiptare gjatë shekujve, pavarësisht nga fondkrijuesi, gjuha, alfabeti, përmbajtja apo tipologjia e shkrimit.

Neni 19

1. Arkivat shtetërorë, që ruajnë dokumente të së njëjtës tipologji janë Arkivi Qendror i Filmit dhe Arkivi Qendror Teknik.

2. Këta arkiva kontrollojnë zbatimin e këtij ligji dhe japin ndihmë metodologjike e profesionale në arkivat vendorë, ku ruhen dokumentet e së njëjtës tipologji.

Neni 20

1. Arkivat shtetërorë të sistemit funksionojnë pranë këtyre institucioneve: Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Rendit Publik, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Shërbimit Informativ Shtetëror.

2. Institucioni i Kuvendit të Shqipërisë dhe ai i Presidentit i administrojnë dokumentet respektive në arkiva që funksionojnë në mënyrë të përhershme pranë tyre.

3. Arkivat shtetërorë të sistemit funksionojnë pranë institucioneve shtetërore, të cilat, sipas Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, janë institucione të pavarura.

4. Arkivi shtetëror i sistemit të drejtësisë (gjykatat e prokuroritë) krijohet dhe funksionon pranë Ministrisë së Drejtësisë.

5. Arkivat e sistemit funksionojnë sipas kërkesave të këtij ligji.

Neni 21

1. Arkivat shtetërorë të sistemit administrojnë dhe ruajnë dokumentet e trashëguara, si dhe dokumentet e krijuara gjatë veprimtarisë së institucioneve që, sipas ligjit, e dorëzojnë pasurinë arkivore pranë tyre. Ata kontrollojnë zbatimin e ligjit dhe japin ndihmë metodike në arkivat e institucioneve shtetërore të varësisë së tyre.

2. Arkivat shtetërorë të sistemit janë në varësi administrative të drejtpërdrejtë të drejtuesit të institucionit.

Neni 22

1. Arkivat shtetërorë vendorë administrojnë dhe ruajnë dokumentet e trashëguara, si dhe dokumentet e arkivave të institucioneve shtetërore vendore dhe të organeve të qeverisjes vendore, që veprojnë brenda njësisë administrativo-territoriale përkatëse. Ata kontrollojnë dhe japin ndihmë metodike në arkivat e pushtetit vendor dhe të institucioneve shtetërore vendore, që veprojnë në njësinë administrativo-territoriale përkatëse.

2. Arkivat shtetërorë vendorë janë të detyruar të regjistrojnë çdo pasuri dokumentare joadministrative, që ekziston në territorin e njësisë së tyre administrativo-territoriale.

3. Këto pasuri i bëhen të ditura menjëherë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe ruhen në Arkivin Qendror Shtetëror.

Neni 23

1. Arkivat e institucioneve shtetërore qendrore dhe vendore janë pjesë organike e tyre dhe varen drejtpërdrejt nga drejtuesi i institucionit.

2. Në varësi të vëllimit të dokumenteve që krijohen, pranë çdo institucioni shtetëror funksionojnë: sekretaria dhe arkivi, sekretari-arkivi ose punonjësi i ngarkuar me shërbimin në sekretari-arkiv.

Neni 24

Arkivat e institucioneve shtetërore qendrore dhe vendore kanë detyrë:

- a) të evidentojnë korrespondencën që dërgohet ose merret nga institucioni;
- b) të bëjnë përpunimin arkivor, të ruajnë dhe të shërbejnë dokumentet që administrojnë;
- c) të dorëzojnë dokumentet në arkivat shtetërorë, sipas afateve ligjore përkatësisht sipas përshkrimit në nenin 9 shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “d” të këtij ligji.

KREU IV ARKIVAT PRIVATË

Neni 25

1. Arkivat privatë e ushtrojnë veprimtarinë e tyre pasi licencohen nga Këshilli i Lartë i Arkivave me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Kriteret për licencim përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

2. Pasuritë, që administrohen në arkivat privatë, gëzojnë të njëjtën mbrojtje nga shteti si ato të arkivave publikë.

Neni 26

1. Pasuri të arkivave privatë, për arsye historike ose me interes publik, mund të shpallen dokumentet me rëndësi historike kombëtare. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, si dhe arkivi privat kanë të drejtën e nismës, ndërsa të drejtën e vendimit të shpalljes e ka Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

2. Shpallja “dokumente me rëndësi historike kombëtare” e pasurive dokumentare, që ruhen në arkivat privatë, nuk cenon, kufizon ose ndryshon marrëdhënien e pronësisë.

3. Përfaqësuesi i arkivit privat ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e përcaktimit të dokumenteve në pronësi të tij, të shpallura me rëndësi historike kombëtare. Vendimi për ndryshimin e statusit të dokumenteve të shpallura me rëndësi historike kombëtare merret në të njëjtën formë, me të njëjtën procedurë dhe nga të njëjtat autoritete, si në rastin e shpalljes së tyre si të tilla.

Neni 27

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, kur nis procedurën për shpalljen e dokumenteve në pronësi të arkivave privatë, si dokumente me rëndësi historike kombëtare, njofton menjëherë pronarët ose përfaqësuesit e këtyre të fundit.

2. Efektet ligjore të vendimit hyjnë në fuqi një ditë pas shpalljes.

Neni 28

1. Dokumentet e arkivave privatë, që shpallen me rëndësi historike kombëtare nuk kanë afat të parashkrueshëm. Shpallja e tyre si të tilla nuk është pengesë për transferimin e të drejtës së pronësisë dhe të të drejtave të tjera mbi këto dokumente.

2. Arkivat privatë, që kanë në pronësi dokumente të shpallura me rëndësi historike kombëtare, në rastin e ndryshimit të pronësisë, janë të detyruara t’i bëjnë të njohur paraprakisht blerësit statusin e dokumenteve të tyre.

Neni 29

1. Asgjësimi i dokumenteve të shpallura me rëndësi historike kombëtare, në pronësi të arkivave privatë, është i ndaluar.

2. Asgjësimi i dokumenteve që e kanë plotësuar afatin ligjor të ruajtjes, pronë e arkivave

privatë, bëhet me të njëjtat procedura si për arkivat shtetërorë. Ligjshmëria e vendimit për asgjësim miratohet zyrtarisht dhe me shkrim nga autoritetet e arkivave shtetërore përkatës.

Neni 30

Dokumentet e shpallura me rëndësi historike kombëtare, në pronësi të arkivave privatë, nuk mund të shiten dhe të dhurohen jashtë vendit.

Neni 31

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në cilësinë e përfaqësuesit të shtetit shqiptar, gëzon të drejtën e parablerjes së dokumenteve të shpallura me rëndësi historike kombëtare, që ndodhen në pronësi të subjekteve private.

2. Kur subjektet private dëshirojnë të shesin dokumente të shpallura me rëndësi historike kombëtare, ato duhet të paraqesin pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave përshkrimin e tyre, në përputhje me normën e njësuar në fuqi. Subjekti privat që ka në pronësi dokumente të tilla është i detyruar të paraqesë me shkrim të dhënat e kërkuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, pas këshillimit të të dhënave përshkrimore, të vlerësuara nga Komisioni i Përhershëm i Ekspertëve, vendos për dhënien ose jo të lejes për shitjen, si dhe për kushtet e tregtimit të këtyre dokumenteve. Në çdo rast Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave është e detyruar t'i kthejë përgjigje pronarit të dokumenteve brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të të dhënave përshkrimore për to. Kundër vendimit të dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, personi ka të drejtën e ankimit në gjykatë, sipas Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 32

Shteti liron nga detyrimet vjetore fiskale pronarët e arkivave privatë, që u dhurojnë arkivave shtetërore dokumente të shpallura me rëndësi historike kombëtare, në përputhje me ligjin nr.7892, datë 12.12.1994 "Për sponsorizimet".

Neni 33

Arkivat privatë, që administrojnë dokumente të shpallura me rëndësi historike kombëtare janë të detyruar të bëjnë regjistrimin e tyre në evidencën e arkivave shtetërore, qendrorë ose vendorë dhe në përputhje me legjislacionin për trashëgiminë kulturore. Regjistrimi i tyre bëhet jo më vonë se një vit nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Me mbarimin e këtij afati, çdo tjetërsim ose shitblerje e dokumenteve me rëndësi historike kombëtare në pronësi të tyre është i paligjshëm.

Neni 34

1. Pronarët e arkivave privatë, që u dhurojnë ose u shesin arkivave shtetërore dokumente me rëndësi historike kombëtare, gëzojnë të drejtën e pronësisë intelektuale, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Këto të drejta i gëzon çdo subjekt privat për dokumentet e krijuara jashtë funksioneve shtetërore.

Neni 35

1. Kur subjektet shtetërore privatizohen, dokumentet e tyre mbeten pronë e shtetit. Institucionet e administratës shtetërore, që bëjnë privatizimin, janë të detyruara të dorëzojnë paraprakisht në arkivat shtetërore përkatës, qendrorë ose vendorë, arkivat e subjekteve shtetërore që privatizohen.

2. Autoritetet e arkivave shtetërorë vendosin për dhënien e pjesshme ose të plotë të kopjeve të dokumenteve, që lidhen me teknikën dhe teknologjinë e prodhimit, pronarit të ri joshtetëror, me kërkesën e këtij të fundit. Shpenzimet e riprodhimit të dokumenteve janë të palës kërkuese.

KREU V ARKIVAT E NUMERIZUAR

Neni 36

1. Dokumentet e numerizuara, pavarësisht nga forma e regjistrimit dhe e qarkullimit, kanë vlerë administrative e juridike vetëm nëse janë hartuar e janë ruajtur sipas standardeve të miratuara.

2. Përshkrimi ligjor i dokumentit të numerizuar bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe institucionet shtetërore të shërbimit informatik. Ato përgatisin rregulla të detyrueshme për hartimin, evidencimin, qarkullimin, përpunimin tekniko-shkencor, ekspertizën e vlerës së ruajtjes e asgjësimit, si dhe për ruajtjen, dublikimin, riprodhimin dhe legalizimin e dokumenteve të numerizuara. Këto rregulla miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 37

Dokumentet e numerizuara janë të vlefshme si pasuri arkivore nëse janë regjistruar në formë të pandryshueshme që në aktin e krijimit.

Neni 38

Kalimi i dokumentit që është krijuar në bartës material (letër, pergamenë) në dokument, në formë të numerizuar, bëhet duke ruajtur njëshmërinë me origjinalin.

Neni 39

Dokumentet e numerizuara ruhen pranë arkivave të institucioneve shtetërore, qendrore dhe vendore. Në mbarim të afatit ligjor të ruajtjes pranë tyre, ato dorëzohen në arkivat shtetërorë respektivë, sipas përshkrimit në nenin 9 të këtij ligji.

Neni 40

Institucionet fondkrijuese të dokumenteve të numerizuara dorëzojnë pranë arkivave përkatës, në të njëjtët bartës që kanë regjistruar dokumentet, edhe mjetet e informimit dhe të kërkimit arkivor.

Neni 41

1. Arkivat e numerizuar janë pjesë e rrjetit arkivor kombëtar. Arkivat e numerizuar i nënshtrohen së njëjtës disiplinë ligjore për ruajtjen, komunikimin dhe shërbimin.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ka të drejtën e përcaktimit të programeve të numerizimit të dokumenteve në institucionet fondkrijuese.

KREU VI DORËZIMI I DOKUMENTEVE NË ARKIVAT SHTETËRORË

Neni 42

1. Dokumentet arkivore, me mbarimin e afatit të shërbimit operativ pranë arkivave të institucioneve fondkrijuese, dorëzohen nga këta të fundit për ruajtje dhe administrim në arkivat shtetërorë, në përputhje me nenin 9 shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “d” të këtij ligji, të sistemuara dhe

të inventarizuara, sipas rregullave të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Bashkë me dokumentet dorëzohen:

- a) dy kopje të inventarit;
- b) një kopje inventari në regjistrim të numerizuar, që përputhet me programin e informatizimit të arkivit, ku dorëzohen dokumentet.

Neni 43

Dorëzimi i dokumenteve të institucioneve shtetërore në arkivat përkatës, përshkruar sipas nenit 9 shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “d” të këtij ligji, bëhet sipas këtyre afateve normative:

a) dokumentet administrative dorëzohen pasi të kenë kaluar 10 vjet nga data e krijimit të tyre. Ky afat është i detyrueshëm edhe për dokumentet në figurë, në zë e në lëvizje, që përbëjnë dokumente administrative;

b) dokumentet tekniko-shkencore dorëzohen pas mbarimit të nevojave për shërbim operativ, por jo më vonë se 25 vjet nga viti i krijimit të tyre;

c) dokumentet në figurë, në zë e në lëvizje dorëzohen pasi të kenë kaluar 15 vjet nga data e krijimit të tyre;

ç) regjistrat e akteve të gjendjes civile dorëzohen pasi të kenë kaluar 75 vjet nga data e krijimit të tyre;

d) dokumentet e klasifikuara “sekret shtetëror” dorëzohen pas deklasifikimit të tyre. Deklasifikimi bëhet nga autoriteti klasifikues.

Neni 44

Dokumentet e institucioneve qendrore e vendore të administratës shtetërore dorëzohen në rrjetin shtetëror të arkivave drejtpërdrejt nga institucioni që i ka krijuar.

Neni 45

1. Arkivat e institucioneve qendrore e vendore të administratës shtetërore, që e mbyllin veprimtarinë e tyre për çfarëdo lloj shkaku, dorëzohen menjëherë pranë arkivave përkatës, sipas nenit 9 shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “d” të këtij ligji.

2. Kur funksionet ose atributet e një institucioni shtetëror barten ligjërisht te një institucion tjetër, ky i fundit mund të administrojë dokumentet e trashëguara deri në mbushjen e afateve të parashikuara në nenin 43 të këtij ligji.

Neni 46

1. Institucionet arkivore shtetërore të përshkuara në nenin 9 shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “d” të këtij ligji kanë të drejtë të tërheqin para afatit normativ dokumentet e krijuara prej institucioneve të administratës shtetërore qendrore e vendore, në rast rreziku të dukshëm dëmtimi a zhdukjeje fizike.

2. Në këtë rast, si dhe kur veprimtaria e një institucioni shuhet, shpenzimet për përpunimin arkivor të dokumenteve përballohen nga institucioni fondkrijues, kur ky ekziston, ose nga institucioni i burimit të varësisë.

Neni 47

Dokumentet e subjekteve joshtetërore, të personave juridikë e fizikë privatë, si dhe ato të personaliteteve shkencore, politike, kulturore, të krijuara jashtë përgjegjësisë të tyre shtetërore, të shpallura me interes historik kombëtar, dorëzohen në arkivat shtetërore me vullnetin e tyre ose të trashëgimtarëve, me marrëveshje.

Neni 48

Arkivat e përshkruar në nenin 9 shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d” dhe “dh” të këtij ligji janë të vetmet institucione shtetërore që kanë të drejtën e blerjes dhe të administrimit të trashëgimisë dokumentare dhe të dorëshkrimeve.

Neni 49

1. Studiuesit dhe punonjësit shkencorë, që bëjnë kërkime për projekte të institucioneve arkivore, kërkimore-shkencore shtetërore në arkiva të vendeve të tjera dhe marrin prej tyre dokumente, janë të detyruar t'i dorëzojnë ato në arkivin e institucionit ku punojnë, si dhe të dërgojnë në arkivat shtetërorë përkatës një relacion me përshkrime të hollësishme për sasinë dhe përmbajtjen e tyre.

2. Në këto raste, studiuesit dhe punonjësit shkencorë kanë të drejtën e një kopjeje falas të dokumenteve. Kopja u ofrohet nga arkivi pranues.

Neni 50

Institucionet joshtetërore, personat juridikë e fizikë privatë që dhurojnë, lënë në trashëgim a për ruajtje ose u shesin dokumente arkivave shtetërorë, gëzojnë të drejtën për të marrë, sipas marrëveshjes, riprodhime falas të tyre.

Neni 51

Në rast të ndryshimeve në organizimin administrativo-territorial, të riorganizimit të veprimtarisë së organeve shtetërore, njoftohet Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ose arkivat shtetërorë, të përshkruar në nenin 9 shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d” dhe “dh” të këtij ligji, për të vendosur për administrimin e mëtejshëm të dokumenteve.

Neni 52

Dokumentet e shpallura me rëndësi historike kombëtare në pronësi a zotërim të subjekteve joshtetërore dhe personave juridikë e fizikë privatë, kur këto e shuajnë veprimtarinë e tyre ose nuk kanë trashëgimtarë të njohur me ligj, depozitohen në arkivat shtetërorë.

KREU VII KOMUNIKIMI DHE SHFRYTËZIMI I DOKUMENTEVE TË FONDIT ARKIVOR KOMBËTAR

Neni 53

1. Shërbimi arkivor garanton të drejtën për t'u njohur me dokumentet që dëshmojnë veprimtarinë e administratës shtetërore.

2. Personi dhe institucionet janë të barabartë në të drejtën për shërbim arkivor.

3. Fondkrijuesit gëzojnë të drejtën e shfrytëzimit të dokumenteve në çdo kohë, pavarësisht nga afatet e përcaktuara në nenin 61 të këtij ligji.

4. Fondkrijuesit joshtetërorë kanë të drejtën e kufizimit të shërbimit me dokumentet e tyre në afate të ndryshme nga ato të përcaktuara në nenin 61 të këtij ligji.

Neni 54

1. Shërbimi arkivor ofrohet pa autorizim.

2. Shfrytëzimi i arkivave shtetërorë e privatë u ofrohet kërkuesve, pavarësisht nga kombësia, shtetësia, statusi ose funksioni i tyre.

3. Autoriteti arkivor shtetëror, kur është e nevojshme, ofron vetëshërbim.

Neni 55

Kërkuesi i një dokumenti nuk është i detyruar të paraqesë arsye për t'u lejuar që ta shfrytëzojë atë.

Neni 56

Kërkesa për shfrytëzim dokumentesh mund të mos pranohet nëse shërbimi për to është i kufizuar me ligj.

Neni 57

Nëse një arkiv nuk e ka dokumentin e kërkuar, kur është e mundshme, i tregon kërkuesit se në cilin arkiv ose autoritet publik ndodhet.

Neni 58

Punonjësit e rrjetit arkivor kombëtar shërbejnë dokumentet besnikërisht me origjinalin, pa komente ose interpretime.

Neni 59

Mjetet e informacionit dhe të kërkimit arkivor janë të hapura. Shërbimi i tyre nuk mund t'i kufizohet askujt.

Neni 60

Shfrytëzimi i dokumenteve të fondit arkivor kombëtar bëhet sipas kërkesave të këtij ligji, nëpërmjet:

- a) shërbimit të dokumenteve ose riprodhimeve të tyre (mikrofilma, fotokopje) për studim në sallat e leximit të arkivave;
- b) botimit të udhërrëfyesve, katalogëve, inventarëve, si dhe përmbledhjeve me dokumente;
- c) përgatitjes dhe hapjes së ekspozitave dokumentare. Ekspozimi i dokumenteve origjinale lejohet vetëm kur sigurohet ruajtja fizike dhe teknologjike, sipas rregullave në fuqi;
- ç) publikimit në organet e shtypit, radios, medias, multimedias dhe kinematografisë;
- d) dhënies së burimeve institucioneve shtetërore e joshetërore për problemet që u interesojnë;
- dh) të gjitha formave të promocionit të vlerave kulturore që ruhen në arkiva;
- e) shërbimit të numerizuar në distancë.

Neni 61

1. Dokumentet e publikuara një herë janë lirisht të shfrytëzueshme.
2. Dokumentet që administrohen në institucionet arkivore shtetërore, jepen për shfrytëzim pasi kanë kaluar 25 vjet nga data e krijimit.

Neni 62

Dokumentet që përmbajnë të dhëna të rëndësishme për sigurimin e interesave të lartë të shtetit, që janë pranuar në arkivat shtetërorë para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe nuk janë deklasifikuar ende, jepen për shfrytëzim, sipas kërkesave të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””.

Neni 63

Arkivat mbrojnë jetën intime të personit. Ndalohej njohja, shfrytëzimi dhe publikimi i dokumenteve që përmbajnë të dhëna me karakter vetjak dhe cenojnë jetën private të personit. Dokumentet që përmbajnë të dhëna me karakter vetjak dhe cenojnë jetën intime të personit, shërbejnë

vetëm pasi kanë kaluar, sipas rastit, 50 deri në 150 vjet nga data e krijimit të tyre.

Neni 64

Dokumentet e pronësisë u shërbejnë trashëgimtarëve të pronës, përfaqësuesve të tyre ligjorë dhe institucioneve shtetërore, që kanë kompetenca vendimmarrëse të njohura me ligj për trashëgimin e pronave.

Neni 65

1. Institucionet publike në veprim, që kanë autoritet klasifikues për arkivat e tyre dhe institucionet arkivore, që kanë trashëguar informacion të klasifikuar, mund të kufizojnë pjesërisht shfrytëzimin e dokumenteve arkivore, në përputhje me ligjin nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””.

2. Kufizime mund të zbatohen edhe në funksion:

- a) të mbrojtjes së sigurisë kombëtare dhe të normalitetit në marrëdhëniet me jashtë;
- b) të interesave të sigurimit publik;
- c) të fshehtësisë për hetimin dhe ndjekjen e veprimtarive kriminale;
- ç) të respektimit të interesave tregtarë dhe të barazisë në konkurrencë;
- d) të moscenimit të barazisë së palëve në një konflikt;
- dh) të mbrojtjes së ekosistemeve natyrore;
- e) të sigurisë së misionëve mbikëqyrëse, si dhe të kushteve për inspektim dhe kontroll nga administrata;
- ë) të mosdëmtimit të politikës financiare, monetare dhe tatimore të shtetit;
- f) të respektimit të mirëbesimit në vendimmarrje brenda ose ndërmjet autoriteteve publike, për përgatitjen e një dosjeje;
- g) të interesave të tjerë të individit, që vlerësohen të ligjshëm nga institucionet e specializuara.

Neni 66

Shfrytëzimi i dokumenteve arkivore mund të lejohet edhe për rastet e parashikuara në nenin 65, nëse një interes publik më i lartë e përlij hapjen.

Neni 67

1. Leje për shfrytëzim të parakohshëm të dokumenteve, që u kufizohet shërbimi në nenet 61, 62 dhe 63 të këtij ligji, jepen përkatësisht:

- a) nga fondkrijuesi;
 - b) nga autoriteti klasifikues, për dokumentet e klasifikuara “sekret shtetëror;
 - c) nga vetë personi, për dokumentet që përmbajnë të dhëna intime dhe që kanë të bëjnë me dinjitetin personal të tij.
2. Të drejtën e përjashtimit e kanë, gjithashtu:
- a) Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave, për dokumentet që ndodhen në Arkivin Qendror Shtetëror dhe në arkivat shtetërore të qarqeve, pas marrjes së pëlqimit me shkrim të fondkrijuesit, kur ai ekziston;
 - b) drejtuesi i institucionit, për dokumentet që ruhen në arkivat e sistemit ose në arkivat që administrojnë dokumente të së njëjtës tipologji;
 - c) çdo subjekt i autorizuar me ligj.

Neni 68

1. Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave, rrjeti arkivor në varësi të saj dhe çdo njësi e shërbimit arkivor pranë institucioneve të administratës shtetërore, qendrore e vendore, nuk kanë autoritet

klasifikues mbi dokumentet që ruajnë e administrojnë.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave bën deklasifikimin e dokumenteve të klasifikuara “sekret shtetëror”, që ka trashëguar, sipas përgjegjësisë që i njej ligji nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 69

Mjetet e informimit dhe të kërkimit arkivor bëjnë të ditur tërësinë e fondeve të dokumenteve të arkivave. Ato njoftojnë edhe për ekzistencën e dokumenteve të klasifikuara “sekret shtetëror”, por pa deklaruar përmbajtjen e të dhënave të mbrojtura nga ligji.

Neni 70

1. Kur shfrytëzimi i një dokumenti arkivor është miratuar, shërbimi arkivor autorizon këshillimin e tij në njërën nga format e ruajtjes (mikrofilm, riprodhim dhe origjinal) ose dhënien e kopjeve të certifikuara të tij. Shërbimi arkivor mban parasysh, brenda mundësive, zgjedhjen e kërkuesit për shërbim.

2. Fotokopje ose riprodhime në forma të tjera jepen për të ilustruar botimet, për përgatitje ekspozitash, si dhe për shërbime të tjera të ligjshme.

Neni 71

1. Kërkuesi ka të drejtë të njihet me një arsye ligjore për mospranimin e shërbimit, duke përfshirë rastin e dokumentacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”.

2. Kërkuesi ka të drejtë të kërkojë autorizim nga autoriteti klasifikues për t’u njohur me informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”.

3. Autoriteti klasifikues mund të lejojë njohjen e pjesshme, si rrjedhim, fshehjen e pjesshme të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”. Kërkuesi vihet në dijeni për këtë.

Neni 72

Kërkuesi, të cilit nuk i pranohet shërbimi për dokumente të klasifikuara “sekret shtetëror”, ka të drejtën e ankimit në gjykatë ose përpara çdo organi tjetër të paanshëm të parashikuar me ligj.

Neni 73

Shërbimi arkivor nuk është i detyruar të japë për shfrytëzim një dokument të botuar ose që është lehtësisht i shfrytëzueshëm në burime të tjera.

Neni 74

1. Shërbimi arkivor dhe autoritetet publike krijuese të dokumenteve janë të detyruara:

a) të vënë në dijeni publikun për të drejtën për të shfrytëzuar dokumentet arkivore dhe për mënyrën e realizimit të kësaj të drejte;

b) të sigurojnë ushtrimin e kësaj të drejte në dobi të interesave të shtetasve;

c) të kualifikojnë nëpunësit e tyre, për të kryer detyrat dhe detyrimet për zbatimin e kësaj të drejte.

2. Shërbimi arkivor dhe autoritetet publike kanë për detyrë:

a) të bëjnë përpunimin tekniko-shkencor të dokumenteve të tyre, duke i bërë lehtësisht të shfrytëzueshme;

b) të zbatojnë procedura të qarta për asgjësimin e dokumenteve pa vlerë ruajtjeje.

Neni 75

Autoritetet publike, me nismën e tyre, bëjnë të njohura burimet që kanë në dispozicion, në

funksion të transparencës së veprimtarisë të administratës shtetërore, në shërbim të nxitjes së pjesëmarrjes të publikut në çështje me interes për të dhe në funksion të forcimit të shtetit të së drejtës dhe të mirëqeverisjes.

Neni 76

Institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore bëjnë përpjekje të bashkërenduara, mutatis mutandis, për të lehtësuar kushtet e komunikimit të arkivave privatë me arkivat publikë.

Neni 77

1. Kërkesat e institucioneve shtetërore e joshtetërore, si dhe të personave juridikë e fizikë privatë, për studime joshkencore, të dhëna arkivore, kopje ose ekstrakte dokumentesh, që ruhen në arkivat shtetërorë, plotësohen kundrejt pagesës, sipas tarifave të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

2. Shërbimi me fotokopje, për dokumente në funksion të studimeve shkencore universitare-akademike, bëhet me tarifë të diferencuar favorizuese.

Neni 78

1. Sasia e dokumenteve të riprodhuara, që i shërbehen kërkuarës, në bazë të fletë-porosisë së tij, përcaktohet nga autoriteti arkivor shërbyes, në përputhje me objektin e kërkesës.

2. Kërkuarës që shtrembëron burimin në përdorimin publik të dokumentit, nuk i shërbehen riprodhime.

Neni 79

1. Kur subjektet joshtetërore, personat juridikë e fizikë privatë, pronarë ose zotërues a mbajtës të dokumenteve, nuk respektojnë detyrimet e parashikuara nga ky ligj, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave përcakton një afat kushtëzues, për të verifikuar zbatimin e dispozitave ligjore. Nëse detyrimet nuk plotësohen brenda afatit kushtëzues, dokumentet e tyre merren për ruajtje nga arkivat shtetërorë.

2. Në rast se shërbimi arkivor kombëtar vlerëson se ekziston rreziku i dëmtimit të menjëhershëm, që mund të sjellë zhdukje të dokumenteve, ato merren në administrim pa lënë afat kushtëzues.

3. Në të dyja rastet ruhet e drejta e pronësisë dhe e rikthimit të dokumenteve.

KREU VIII EKSPORTIMI DHE IMPORTIMI I DOKUMENTEVE

Neni 80

1. Dokumentet e fondit arkivor kombëtar, që ruhen në arkivat shtetërorë ose privatë paraqiten në mjedise ndërkombëtare, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për qëllime manifestimi, ekspozimi ose promovimi kulturor, si dhe për qëllime historike e shkencore, vetëm kur garantohet me marrëveshje ruajtja e integritetit dhe siguria e tyre fizike, në udhëtim dhe në kohën e veprimtarisë.

2. Vlera e sigurimit përcaktohet me marrëveshje, sipas standardeve ndërkombëtare, nga autoritetet e parashikuara në nenet 82 dhe 83 të këtij ligji.

Neni 81

Dokumentet e fondit arkivor kombëtar, që pësojnë dëmtime gjatë transportit ose për shkak të mikromjedisit, ku do të vendosen gjatë ekspozimit, nuk lejohet të paraqiten në mjedise ndërkombëtare.

Neni 82

Leja për paraqitjen e dokumenteve të fondit arkivor kombëtar në mjedise ndërkombëtare jepet:

- a) për dokumentet që ruhen në Arkivin Qendror Shtetëror dhe arkivat shtetërore vendore, nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave;
- b) për dokumentet që ruhen në arkivat shtetërore të sistemit dhe arkivat që ruajnë dokumente të së njëjtës tipologji, nga drejtuesit e institucioneve të varësisë përkatëse;
- c) për dokumentet që ruhen nga arkivat privatë, nga Këshilli i Lartë i Arkivave.

Neni 83

Dokumentet e fondit arkivor kombëtar, që përbëjnë vlera unike të trashëgimisë kulturore kombëtare, të përcaktuara si të tilla nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, paraqiten jashtë shtetit me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 84

Autoritetet, që kanë të drejtë për dhënie leje për paraqitjen e dokumenteve të fondit arkivor kombëtar në mjedise ndërkombëtare, sipas neneve 82 dhe 83 të këtij ligji, janë të detyruara të përcaktojnë datën e saktë të rikthimit të tyre në vendruajtjen e përhershme. Koha e qëndrimit jashtë shtetit nuk mund të jetë më shumë se një vit nga data e daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë.

Neni 85

Në rastin e lejimit të daljes së përkohshme të dokumenteve të fondit arkivor kombëtar jashtë territorit shtetëror, institucioni miratues është i detyruar t'i shoqërojë ato me lejet përkatëse për autoritetet doganore, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 86

1. Importimi i dokumenteve për pasurimin e arkivave të Shqipërisë bëhet sipas marrëveshjeve të nënshkruara nga palët bashkëpunuese.
2. Pasuritë arkivore, që hyjnë në rrjetin arkivor të Republikës së Shqipërisë përmes importit, shoqërohen me certifikatën që përcakton identitetin dhe prejardhjen e tyre dhe me lejen e autoritetit dërgues.

Neni 87

Shteti shqiptar, sipas legjislacionit në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, ka detyrimin të interesohet e të kërkojë rikthimin në vend të dokumenteve të fondit arkivor kombëtar, që kanë dalë në mënyrë të paligjshme jashtë territorit shtetëror.

Neni 88

1. Kur në territorin e Republikës së Shqipërisë vihet re se ka dokumente të një shteti tjetër, të hyra në rrugë të paligjshme, këto kalojnë në ruajtje të përkohshme pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes.
2. Nëse brenda pesë vjetëve, pas publikimit të ekzistencës së këtyre dokumenteve, nuk paraqiten kërkesa për rikthimin e tyre në vendin e prejardhjes, ato kalojnë në pronësi të shtetit shqiptar.

KREU IX ARKIVISTI

Neni 89

Punonjësi i rrjetit arkivor kombëtar të Republikës së Shqipërisë respekton Kodin Deontologjik Ndërkombëtar të Arkivistëve.

Neni 90

Arkivistët e rrjetit arkivor shtetëror nuk mund të jenë anëtarë të partive politike. Përgjegjësia e tyre si ruajtës të trashëgimisë dhe të informacionit rrjedh nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe përcaktohet nga ligjet në fuqi.

Neni 91

Arkivistët janë të paanshëm në ofrimin e shërbimit për shfrytëzimin e dokumenteve dhe respektojnë kufizimin ligjor për mbrojtjen e të dhënave të jetës private të individit dhe të interesave të veçantë të shtetit, pavarësisht se mund të njihen me to për shkak të detyrës.

KREU X KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE DHE GJOBAT

Neni 92

1. Autoritetet dhe punonjësit e arkivave shtetërore mbajnë përgjegjësi ligjore për shkeljen e kërkesave të këtij ligji. Në kuptim të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 1 deri në 5 paga mujore shkeljet e mëposhtme:

- a) mungesa e kushteve të nevojshme të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për ruajtjen fizike e teknologjike të dokumenteve;
- b) moszbatimi i kërkesave të këtij ligji dhe rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidencimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve;
- c) mosdorëzimi në afat dhe sipas kërkesave të këtij ligji i dokumenteve në arkivat shtetërore;
- ç) mosdhënia e të dhënave të nevojshme për regjistrimin dhe evidencimin e veprimtarisë arkivore e të dokumenteve të tyre arkivave shtetërore, të përcaktuar me ligj;
- d) pengimi i punonjësve të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për të kryer përgjegjësitë e tyre sipas këtij ligji.

2. Shkeljet që kanë të bëjnë me tjetërsimin e dokumenteve dhe humbjen e dokumenteve të arkivit nga persona që i kanë në administrim, kur ato nuk janë kopje e vetme, dënohen me gjobë nga 2 deri në 10 paga mujore.

3. Personat fizikë e juridikë privatë i nënshtrohen gjobës nga 100 mijë deri në 300 mijë lekë kur kanë kryer shkeljet e përmendura në shkronjat “a”, “ç”, “d” të pikës 1 dhe pikën 2 të këtij neni.

4. Gjopa vendoset nga punonjësi i autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

5. Për botimin e burimeve arkivore në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, mbajnë përgjegjësi edhe kërkuesit. Kërkuesi që shkel në mënyrë të përsëritur rregulloren e shfrytëzimit të dokumenteve arkivore, ose dëmton vetë dokumentet, mund të përjashtohet për një periudhë deri 1-vjeçare nga e drejta e shërbimit arkivor.

6. Kundër vendimit të dënimit me gjobë ose të përjashtimit, personat që kanë kryer shkeljet mund të bëjnë ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së vendimit.

7. Asgjësimi i dokumenteve, në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji, vjedhja, si dhe humbja e dokumenteve të shpallura të një rëndësie të veçantë, kur shkelja përbën vepër penale, dënohet sipas Kodit Penal.

KREU XI
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 93

1. Masat për mbrojtjen e dokumenteve në kohë të veçantë rrjedhin nga ligji nr.8756, datë 26.3.2001 "Për emergjencat civile".

2. Rregullat e zhvendosjes (evakuimit), të shmangies dhe të risistemimit të dokumenteve në kohë të veçantë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 94

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 9 pika 3, 14 pika 5, 15 pika 2, 25 pika 1, 36 pika 2, 83 dhe 93 pika 2 të këtij ligji.

Neni 95

Ligji nr.7726, datë 29.6.1993 "Për fondin arkivor kombëtar dhe për arkivat", shfuqizohet.

Neni 96

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.4018, datë 2.12.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

VENDIM
Nr.795, datë 26.11.2003

PËR NGRITJEN, PËRBËRJEN DHE MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM TË VLERËSIMIT TË OBJEKTEVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE, NË PRONËSI PRIVATE, TË LUAJTSHME DHE PËR KRITERET SHKENCORE E PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË KËTYRE OBJEKTEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 4 e 5 të nenit 9 të ligjit 9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore", me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Ngritjen e komisionit të përhershëm të vlerësimit të objekteve të trashëgimisë kulturore, në pronësi private, të luajtshme.

I. KOMISIONI I PËRHERSHËM I VLERËSIMIT

A. PËRBËRJA:

Ky komision të kryesohet nga drejtori i Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurisë Kulturore dhe në përbërje të ketë përfaqësues të institucioneve të mëposhtme:

- | | |
|--|---------|
| - një specialist etnolog nga Instituti i Kulturës Popullore | anëtar; |
| - një specialist organolog nga Instituti i Kulturës Popullore | anëtar; |
| - një specialist arkeolog nga Instituti i Arkeologjisë | anëtar; |
| - një studiues të artit mesjetar nga Instituti i Monumenteve të Kulturës | anëtar; |
| - një studiues të artit pamor nga Galeria Kombëtare e Arteve | anëtar; |

- një studiues të arkitekturës nga Instituti i Monumenteve të Kulturës anëtar.

B. DETYRAT

I. Komisioni ka për detyrë të vlerësojë objektet e trashëgimisë kulturore, në pronësi private, të luajtshme, që dalin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe t'i rekomandojë Ministrin të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, që në mbështetje të aktvlerësimit të objekteve, të autorizojë ose jo nxjerrjen e tyre jashtë këtij territori.

C. MËNYRA E FUNKSIONIMIT

1. Mbledhja e komisionit të përhershëm të vlerësimit

- Mbledhjet e komisionit të përhershëm të vlerësimit zhvillohen në Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore.

- Kryetari përcakton datën, orën, objektin dhe rendin e ditës, të cilat ua komunikon anëtarëve të komisionit.

- Kryetari, me kërkesë të subjektit të interesuar, person fizik ose juridik, drejtuar Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, por jo më vonë se 10 ditë nga depozitimi i kërkesës së të interesuarit, thërret mbledhjen për nxjerrjen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të objekteve.

- Komisioni, pasi shqyrton kërkesën, harton aktvlerësimin e objekteve, dhe brenda 10 ditëve, ia dërgon atë së bashku me dokumentacionin përkatës Ministrin të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

- Komisioni i merr vendimet me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve.

II. KRITERET SHKENCORE TË VLERËSIMIT TË OBJEKTEVE

1. Anëtarët e komisionit, sipas fushave përkatëse, bëjnë vlerësimin e objekteve, sipas listës së katalogimit të objekteve të trashëgimisë kulturore, të miratuar nga Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore.

2. Çdo objekt i shënuar në formularin standard të aplikimit, pajiset me një numër të caktuar dhe një pasaportë identifikuese.

3. Objektet e trashëgimisë kulturore, në pronësi private, të luajtshme, që dalin jashtë territorit të vendit, duhet të regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore dhe të pajisen me pasaportën përkatëse të kësaj qendre.

III. PROCEDURAT E VLERËSIMIT DHE TË DHËNIES SË LEJES

1. Vlerësimi i objekteve të trashëgimisë kulturore, në pronësi private, të luajtshme, bëhet pas kërkesës me shkrim të subjektit të interesuar, person fizik ose juridik, drejtuar Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Kërkesa shoqërohet me:

a) kopjen e formularit standard të aplikimit, të plotësuar në Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore;

b) pasaportën përkatëse për çdo objekt, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore;

c) për personat juridikë, dokumentacionin e plotë ligjor të regjistrimit si person juridik në gjykatë, organet tatimore dhe organe të tjera të specializuara, vërtetimet nga gjykata, prokuroria, përbarimi dhe organet tatimore, që vërtetojnë se personi i interesuar nuk ka detyrime ndaj tyre, si dhe nuk është në proces gjyqësor, civil apo penal;

ç) për personat fizikë, fotokopjen e pasaportës dhe adresën e saktë të vendbanimit, si dhe vërtetimet nga gjykata, prokuroria, përbarimi dhe organet tatimore, që vërtetojnë se personi i interesuar nuk ka detyrime ndaj tyre;

d) mandatpagesën përkatëse nga Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore, sipas numrit të objekteve që kërkohet të dalin jashtë vendit.

2. Kërkesa me shkrim, së bashku me dokumentacionin e mësipërm, kalon për shqyrtim dhe vlerësim në komisionin e përhershëm të vlerësimit.

3. Komisioni, pas shqyrtimit të dokumentacionit të plotë dhe vlerësimit fizik të objekteve, harton aktvlerësimin e objekteve që kërkohet të dalin jashtë territorit të vendit, në tri kopje, njëra për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, njëra për Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurisë Kulturore dhe njëra për subjektin e interesuar.

4. Aktvlerësimi përmban:

- a) Objektet që lejohen të dalin jashtë vendit, shoqëruar me numrin e pasaportës.
 - b) Objektet që ndalohen të dalin jashtë vendit, shoqëruar me numrin e pasaportës.
 - c) Mënyrën se si duhet të veprohet, për objektet që nuk lejohen të dalin jashtë vendit.
5. Komisioni, në bazë të aktvlerësimit të objekteve, vendos me shumicë votash dhe ia përcjell vendimin Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

6. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, brenda 10 ditëve, vendos dhënien ose jo të lejes, për nxjerrjen jashtë territorit të vendit, të objekteve të trashëgimisë kulturore, në pronësi private, të luajtshme, sipas aktvlerësimit të komisionit të përhershëm të vlerësimit. Ndaj vendimit për mosdhënien e autorizimit të Ministrit mund të bëhet ankim, administrativ apo gjyqësor, sipas mënyrës dhe afateve të parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative dhe Kodin e Procedurës Civile.

7. Leja për nxjerrjen e objekteve jashtë territorit të vendit, e miratuar nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, i dërgohet subjektit të interesuar dhe, për dijeni, komisionit të përhershëm të vlerësimit dhe Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore.

8. Subjekti i interesuar paguan këto tarifa:

a) Për aktvlerësimin e objekteve:

- 5 000 (pesë mijë) lekë kur numri i objekteve është më pak se 50.

- 10 000 (dhjetë mijë) lekë kur numri i objekteve është më shumë se 50.

b) Për çdo formular standard të aplikimit, të plotësuar pranë Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore sipas lidhjes nr.1, 100 (njëqind) lekë.

IV. TË ARDHURAT DHE SHPËRBLIMI I ANËTARËVE TË KOMISIONIT

1. Të gjitha të ardhurat nga pagesat e tarifave të mësipërme, kalojnë në buxhetin e Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore.

2. Anëtarët e komisionit të përhershëm të vlerësimit, për kontributin që japin, shpërblehen nga fondi që krijohet nga të ardhurat e mësipërme me 5000 (pesë mijë) lekë, secili për çdo aktvlerësim.

V. ZBATIMI

1. Ngarkohet Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, që brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e vendimit, të miratojë emrat e anëtarëve të komisionit, të propozuar nga institucionet përkatëse.

2. Ngarkohen Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve dhe institucionet e specializuara shkencore për zbatimin e këtij vendimi.

VI. HYRJA NË FUQI.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
QENDRA KOMBËTARE E INVENTARIZIMIT TË PASURIVE KULTURORE

Formular standard i aplikimit

Nr.....dt...../.....2003

NR.	EMRI I OBJEKTIT	NR.PASAPORTËS	SASIA (copë/kopje)
1			
2			
3			
4			
5			
6			
7			
8			
9			
10			
11			
12			
13			
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			
21			
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			

Emri, Mbiemri dhe Firma e aplikantit

Adresa, Tel.&Fax, Mob

VENDIM
Nr.796, datë 26.11.2003

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË MARRËVESHJES SË KREDISË PËR ZHVILLIM
"PROJEKTI I REFORMËS LIGJORE DHE GJYQËSORE", NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 6 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e ndryshimit të Marrëveshjes së kredisë për zhvillim "Projekti i reformës ligjore dhe gjyqësore", ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Shkëlqesisë së Tij Kastriot Islami
Ministër i Financave
20 mars 2003

Subjekti: Kredia 3327 ALB projekti i reformës ligjore dhe gjyqësore - amendime në Marrëveshjen për zhvillimin e kredisë

Shkëlqesi,

Në lidhje me Marrëveshjen për zhvillimin e kredisë për Projektin e sipërpërmendur, datë 18 prill 2000 të amenduar, mes Shqipërisë dhe Lidhjes së Zhvillimit Ndërkombëtar (Lidhja), jemi të kënaqur t'ju informojmë se pjesa C e pjesës I e planifikimit 3 të Marrëveshjes për zhvillimin e kredisë amendohet si vijon:

"Blerje ndërkombëtare

Mallrat me vlerë më pak se 100 mijë dollarë për kontratë, deri në një shumë agregate që nuk i tejkalon 350 mijë dollarë, mund të prokurohet mbi bazën e kontratave që jepen mbështetur në parimet e blerjeve ndërkombëtare në përputhje me dispozitat e paragrafëve 3.5 dhe 3.6 të udhëzimeve."

Ju lutem konfirmoni nëse jeni dakord me paragrafin e mësipërm duke kundërfirmosur të dyja kopjet e kësaj letre amenduese dhe duke na kthyer njërin prej tyre. Pasi Lidhja merr kopjen e firmosur prej jush, kjo letër amenduese i shtrin efektet që nga 1 janari 2003. Ju do të njoftoheni kur ne të marrim letrën e kundërfirmosur prej jush.

Sinqerisht
Për Lidhjen e Zhvillimit Ndërkombëtar
Simon Gray
Drejtore i komanduar
Njësia për Europën Juglindore
Rajoni i Europës dhe Azisë Qendrore

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI TETOR 2003

1.	KUSHTETUTA	600
2.	PËRMBLEDHËSE NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
4.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
5.	KODI PENAL	400
6.	KODI I PUNËS	500
7.	KODI I FAMILJES	450
8.	KODI CIVIL	1000
9.	KODI RRUGOR	900
10.	KODI ZGJEDHOR	355
11.	PËRMBLEDHËSE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
12.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT DOGANOR	1500
13.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

Doli nga shtypi më 10.12.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja Ideart
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë